



Përfitimet nga regjistrimi i tokave bujqësore
- Kreu i KASH, Rrapaj: Formalizimi do rrisë investimet dhe mundësojë kreditimin

Faqe 2

Siguria ushqimore, vetëm 5% e qumështit që prodhohet në vend testohet

Faqe 7

80% e kredive për fermerët jepen nga mikrofinanca, presidentja e shoqatës Muja: Për bujqësinë interesa të ulëta dhe pa kolateral

Faqe 4



AGROBIZNESI

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

FED invest
Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

15-ditëshi i dytë i muajit prill 2024

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 484
Çmimi 125 lekë

E përdryjavshme e pavarur

LETRA E BARDHË PËR SIGURINË USHQIMORE, HARMONIZIM I LEGJISLACIONIT TRAJNIM MBI UDHËZUESIT RREGULLATIVË TË BASHKIMIT EUROPIAN PËR SIGURINË USHQIMORE

UNIDO e përkushtuar për të mbështetur aktorët e tregut për të rritur përgjegjshmërinë dhe standardet e sigurisë ushqimore në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor, duke siguruar që prodhuesit vendas të kenë akses në tregjet ndërkombëtare përmes përmbushjes së standardeve të sigurisë

GOSP ALBANIA
GLOBAL QUALITY AND STANDARDS PROGRAMME

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNIDO
UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



Civici: Varietetet autoktone shqiptare, vlerë për Organizata Ndërkombëtare të Vreshtarisë dhe Verës



Faqe 2

FINANCIM

Si janë shpërndarë paratë e BE-së për bujqësinë shqiptare? - IPARD II, u financuan 513 projekte. U hapën mbi 1 mijë vende të reja pune



Faqe 2

STATISTIKA

Tkurret bujqësia! Është sektori që punëson 1/3 e vendit. Sipas Bankës Botërore duhen më shumë subvencione



Faqe 5

KËNDI I MBROJTJES INTELEGJENTE TË BIMËVE



Mbrojtja biologjike e bimëve nga insektet dëmprurës në bujqësi

Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

Faqe 11

TEMA TË DITËS

- Denaj takim me ambasadorin Bergner, projekte të përbashkëta në bujqësi Fq.4
- Gonxhe: Garanci deri në 70% të marrjes së kredive për sektorin e industrisë përpunuese Fq.4
- Fermerët e Myzeqesë përballen me luhajtjet e çmimeve të shitjes së perimeve, një pjesë e prodhimit po u ngelet pa shitur Fq.4
- Prodhimi vendas nuk mjafton, importet e kafshëve të gjalla për mish u rritën me 62% në janar-mars Fq.5
- Gardhet ushqimore - një formë e polikulturës në bujqësi - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.14

TEMA TË DITËS

Rama në Theth: “Paketa e Maleve” mbështetje e re për vendasit që duan të investojnë në tokën e të parëve

Turizmi malor dhe investimet për rigjallërimin e tij vijnë të mbeten një prioritet, tashmë i përforcuar me një paketë të re të mbështetjes për investimet në këto zona.

Kjo paketë do t'i hapë rrugë një zhvillimi intensiv, përmes inkurajimit dhe mbështetjes së investitorëve vendas, që kursimet e punës në emigracion, duan t'i investojnë në tokat e të parëve të tyre.

Kryeministri Edi Rama u takua në Theth me drejtues bujtinash dhe agroturizmsh nga ku njoftoi edhe zhvillimin më të ri.

“Kur them që Zoti e bëri Shqipërinë për telha ditën e dielë kur ishte pushim, kush nuk e beson duhet të vijë këtu në Theth të shohë se ku e ka vendosur pikën e parë kur e ka filluar pikturën nga maja deri poshtë, magji! Ja ku jam këtu sot me pararojën e Shqipërisë 2030, këtu në Theth. Tani jemi këtu me një duar shtrëngim solemn, që në 30 qershor këtu të gjithë do të kenë në dorë titullin e pronës së shumëpritur, që pasi i trashëguan nga stërgjyshërit, akoma nuk e kanë dot për arsye që janë të arsyeshme, por që prapë nuk duan t'i dëgjojnë më”, theksoi Rama.

Kryeministri Rama u shpreh se “më 30 qershor, shtëpitë e stërgjyshërve, ato që janë ndërtuar më pas dhe janë në procese për t'u legalizuar do

të kthehen në certifikata pronësie dhe ndërkohë do të jetë gati dhe “Paketa e Maleve”.

“Paketa e Maleve do të ketë

pasur më ato hallet e pafundme të zinxhirit të pronave dhe pa pasur as nevojë të kalojnë në të gjithë atë procedurë që kërkon



brenda një sërë masash që të gjithë ata që i kanë lënë këto male në kërkim të një jete më të mirë, të kthehen dhe me bukuritë e këtyre maleve të bëjnë sukses, të bëjnë ekonomi, të bëjnë mirëqenie dhe t'u lënë fëmijëve të tyre trashëgimi një pasuri të jashtëzakonshme”, tha kryeministri në bisedën me ta.

Ndërkohë që më herët, kryeministri shpjegoi lidhur me paketën e re.

“Paketa e re e mbështetjes për investimet në këto male, do t'i hapë rrugë të gjithë atyre që i kanë lënë këto male në kërkim të një jete më të mirë dhe që kanë punuar pa pushim dhe që kanë kursyer e kursenjë që kursimet e tyre t'i investojnë në tokat e të parëve me një lehtësi të plotë, pa

firmit e të gjithëve që janë të shpërndarë lart e poshtë, me një mbështetje të fuqishme, qoftë në aspektin e dhënies së lejeve për të rihapur shtëpitë e të parëve për të ndërtuar agroturizme, për të fituar shumë më tepër se ç'fitojnë nga puna e lodhshme në shërbim të të tjerëve atje ku janë”, tha Rama.

Kryeministri Rama u shpreh se “njëkohësisht për t'i dhënë mundësi ekonomisë që të fuqizohet edhe me shumë falë miliona e miliona turistëve që po mësyjnë në Shqipëri edhe me shumë këtë vit se 10 milionët e vitit të shkuar, që do të thotë shumë më tepër të ardhura, shumë më tepër punë për të gjithë zinxhirin e prodhimeve të vendit e mbi të gjitha shumë më tepër krenari për Shqipërinë”.

Përfitimet nga regjistrimi i tokave bujqësore - Kreu i KASH, Rrapaj: Formalizimi do rrisë investimet dhe mundësojë kreditimin

Formalizimi apo regjistrimi i tokave bujqësore nuk është përmbyllur ende, ndërsa ajo që është bërë me dije nga Ministria e Bujqësisë është se 60 për qind e regjistrave kadastralë janë digjitalizuar, ç'ka do të thotë se të dhënat kanë kaluar në sistem.

Nga studio e emisionit “Box to Box” Agim Rrapaj, kreu i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar rendit përfitimet që kanë qytetarët nga finalizimi i këtij

procesi, që kanë të bëjnë me krijimin e mundësisë për sigurimin e pronës, kreditimin dhe rritjen e investimeve.

Rrapaj vuri në dukje se procesi nuk ka përfunduar kryesisht për veriun e vendit, teksa shtoi se ka nisur një projekt pilot për të bërë të mundur përsheptimin e formalizimit të tyre e më pas digjitalizimin e të dhënave.

Ky proces paraprind edhe aplikimin e taksës së re, që do të nisë të

aplikohet prej 2028-ës. Kujtojmë që për të mundur përsheptimin e procesit të regjistrimit të tokave bujqësore të ndara me ligjin 7501, është hequr nga lista e detyrimeve pagesa e taksës së pronës.

Ç'ka do të thotë se qytetarët kanë mundësi të marrin në duar tapinë pa qenë të kushtëzuar, që të kryejnë paraprakisht pagesën e kësaj tarife e cila aktualisht varion nga 700 deri në 5600 lekë në vit për hektarë.



PËRFITIMET NGA REGJISTRIMI I TOKAVE BUJQËSORE

KREU I KASH, RRAPAJ: FORMALIZIMI DO RRIË INVESTIMET DHE MUNDËSOJË KREDITIMIN

Civici: Varietetet autoktone shqiptare, vlerë për Organizata Ndërkombëtare të Vreshtarisë dhe Verës

Zëvendësministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Enio Civici përfaqësoi Shqipërinë në ministerialin për Vreshtarinë dhe Verën, që u zhvillua në Itali.

Ky aktivitet u organizua nga Organizata Ndërkombëtare e Vreshtarisë dhe Verës dhe ministri italian i Bujqësisë dhe Sovranitetit Ushqimor Francesco Lollobrigida.

Civici e vlerësoi këtë takim me rëndësi të veçantë për çështjet e vreshtarisë dhe industrisë

së prodhimit të verës, ku siç tha ai “Shqipëria është vendi i 50-të që i bashkohet OIV në 100 vjetorin e kësaj organizate”.

“Folëm për zhvillimin e sektorit të vreshtarisë dhe verës në Shqipëri dhe vlerat që varietetet autoktone shqiptare sjellin në këtë organizatë”, tha Civici.

Anëtarësimi i Shqipërisë në Organizatën Ndërkombëtare të Vreshtarisë dhe Verës (OIV), në gusht të 2023, erdhi pas një pune të madhe që ka bërë

MBZHR bashkë me ekspertët e fushës për të plotësuar çdo hallkë të zinxhirit që kërkon ky proces ndërkombëtarizim i industrisë së verës “Made in Albania”.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural po mbështet zhvillimin e industrisë së verës, si një nga produktet tradicionale më të hershme në vendin tonë, që e ka bërë Shqipërinë të njihet për varietetet autoktone të rrushit, prej nga prodhohen një sërë verërash cilësore.



Si janë shpërndarë paratë e BE-së për bujqësinë shqiptare? - IPARD II, u financuan 513 projekte. U hapën mbi 1 mijë vende të reja pune

Mbështetja financiare në bujqësi nga fondet e Bashkimit European, përmes programit IPARD II ka i ka ardhur në ndihmë afo 513 bizneseve në të gjithë vendin. Në takimin e 12-të i Komitetit të Monitorimit të Programit IPARD II 2014 – 2020, strukturë e cila mbikëqyr zbatimin e këtij programi, është bërë edhe një analizë se ku janë shpërndarë fondet deri më tani. Referuar të dhënave, nga zbatimi i programit janë mbështetur: 137 investime në mekanikë bujqësore dhe shtim sipërfaqesh të mbjella; 80 investime në subjekte agro-turistike; 73 investime në serra; 72 pika grumbullimi; 46 investime në kantina dhe vreshta; 40 fabrika përpunimi agro-ushqimor; 34 investime në stalla e ferma blegtorale; 31 investime në energji të rinovueshme.

Gjithashtu programi ka impaktuar direkt në nxitjen e punësimit duke krijuar mbi 1000 vende të reja të pune të lidhura me diversifikimin e aktiviteteve bujqësore dhe jo bujqësore në fermë dhe jashtë saj.

Programi ka ofruar

mbështetje për sipërmarrësit e rinj (nën 40 vjeç) dhe sipër-

Komisioni European ka ndërprerë përkohësisht pagesat e



marrëset gra të cilët përbëjnë përkatesisht 50% dhe 25% të projekteve të financuara, duke krijuar mjedisin mundësues për rritjen dhe fuqizimin e të rinjve dhe grave të angazhuar në sektorin bujqësor.

Deri në fund të vitit 2024, në përfundim të programit IPARD II, Strukturat Shqiptare parashikojnë të realizojnë pagesat ndaj fermerëve deri në 79% e buxhetit të Bashkimit Evropian të alokuar për këtë Program.

Në Korrik të vitit të kaluar,

programit IPARD II si dhe ka ngrirë procedurat për IPARD III, deri në një vendim të dytë, për shkak se ka të dhëna për mangësi në dhënie dhe zbatimin e projekteve.

Programi IPARD synon mbështetjen e sektorit bujqësor dhe zhvillimin rural, duke nxitur zhvillimin ekonomik në zonat rurale, përmirësimin e cilësisë së jetesës, dhe të përgatitës sektorit bujqësor për tregun konkurrues të BE-së.

LETRA E BARDHË PËR SIGURINË USHQIMORE, PIKË KYÇE NË HARMONIZIMIN E LEGJISLACIONIT

TRAJNIM MBI UDHËZUESIT RREGULLATIVË TË BASHKIMIT EUROPIAN PËR SIGURINË USHQIMORE

UNIDO e përkushtuar për të mbështetur aktorët e tregut për të rritur përgjegjshmërinë dhe standardet e sigurisë ushqimore në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor, duke siguruar që prodhuesit vendas të kenë akses në tregjet ndërkombëtare përmes përmbushjes së standardeve të sigurisë

Në datat 15-16 prill 2024, Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial (UNIDO) nëpërmjet Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP) e mbështetur nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), organizoi një trajnim mbi “Udhëzuesit Rregullativ të BE-së”.

Në këtë trajnim, përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF), Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT), ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që operojnë në sektorin e bimëve aromatike dhe mjekësore, si dhe laboratorët privatë, u pajisën me njohuri thelbësore për të rritur përgjegjshmërinë dhe standardet e sigurisë ushqimore.

Legjislacioni i harmonizuar i BE-së për sigurinë ushqimore

Legjislacioni i harmonizuar i BE-së për sigurinë ushqimore ofron një sërë rregulloresh dhe direktivash që rregullojnë aspektet e ushqimit nga higjiena e prodhimit deri te informacioni për konsumatorin. Rregulloret themelore si Rregullorja Nr. 178/2002 dhe Rregullorja Nr. 852/2004 vendosin standarde dhe kërkesa të përgjithshme për sigurinë dhe cilësinë e ushqimit, ndërsa Rregullorja Nr. 1169/2011 përqendrohet në etiketimin dhe informacionin për konsumatorët. Me themelimin e Autoritetit Evropian të Sigurisë Ushqimore (EFSA), BE-ja ka qasje të qëndrueshme në këshilla shkencore të pavarura për të mbështetur zhvillimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e sigurisë ushqimore.

Legjislacioni dhe standardet për sigurinë ushqimore në BE

Legjislacioni dhe standardet për sigurinë ushqimore në BE janë thelbësore për mbrojtjen e shëndetit publik dhe sigurinë e konsumatorëve. Këto rregulla dhe standarde përcaktojnë kriteret dhe procedurat për të siguruar që ushqimi të jetë i sigurt dhe cilësor në çdo fazë të prodhimit dhe tregtimit. Në BE, legjislacioni dhe standardet për ushqimin përfshijnë një gamë të gjerë masash, nga kontrolli



i higjienës së prodhimit deri te etiketimi i produktit dhe komunikimi i rrezeve të mundshme për shëndetin publik.

Një aspekt i rëndësishëm i këtij legjislacioni është siguri- mi që konsumatorët kanë qasje në informacion të saktë dhe të plotë lidhur me cilësinë dhe origjinën e ushqimit që konsumojnë. Përveç kësaj, rregullat dhe standardet e BE-së për ushqimin janë të harmonizuara me standardet ndërkombëtare si Codex Alimentarius, për të siguruar që produktet e importuara dhe eksportuara përputhen me standardet e pranura ndërkombëtare për cilësinë dhe sigurinë e ushqimit.

Në fund, legjislacioni dhe standardet për sigurinë ushqimore në BE synojnë të krijojnë një mjedis të sigurt dhe të besueshëm për konsumatorët, duke u përpjekur për të zvogëluar rreziqet e mundshme për shëndetin publik dhe duke siguruar që ushqimi të përmbushë standardet më të larta të cilësisë dhe sigurisë. Kjo

përqasje ndihmon në forcimin e besimit të publikut në ushqimin e tyre dhe në rritjen e integritetit të tregut ushqimor në BE.

Letra e Bardhë për Sigurinë Ushqimore

Një pikë kryesore në harmonizimin e legjislacionit për ushqimin në BE është Letra e Bardhë për Sigurinë Ushqimore (2000), i cili përcakton plane për një politikë ushqimore proaktive, modernizimin e legjislacionit në rregulla koherente dhe transparente, përf forcimin e kontrolleve nga ferma në tavolinë dhe përmirësimin e sistemit të këshillimit shkencor për mbrojtjen e konsumatorit. BE-ja ka një qasje të qëndrueshme në këshilla shkencore për të mbështetur zhvillimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e sigurisë ushqimore.

Tolerancat e importit dhe Codex MRLs

Tolerancat e importit dhe

Codex MRLs janë aspekte të rëndësishme të legjislacionit të sigurisë ushqimore në BE. Këto tolerance përqendrohen në përcaktimin e niveleve maksimale të mbetjeve të pesticideve në ushqim, të njohura si MRL (Maximum Residue Levels) dhe tolerancat e importit, të cilat janë MRL-të e vendosura për të siguruar që produktet e importuara përmbushin nevojat e tregtisë ndërkombëtare. Këto standarde janë të bazuara në rekomandimet e Kodit të Ushqimit (Codex Alimentarius) dhe janë të detyrueshme për të gjitha ushqimet në tregun e BE-së.

Menaxhimi i niveleve të mbetjeve të pesticideve dhe zbatimi i tolerancave të importit janë thelbësore për të ruajtur sigurinë dhe cilësinë e ushqimit për konsumatorët e BE-së. Për të përmbushur këto kërkesa, BE-ja ka një proces të strukturuar për vendosjen dhe përditësimin e MRL-ve, duke u mbështetur në ekspertizën e Komitetit të Codex për Mbet-

jet e Pesticideve (CCPR) dhe në takimin e përbashkët FAO/OBSH për mbetjet e pesticideve (JMPR). Kjo siguron që ushqimi në tregun e BE-së të përmbushë standardet më të larta të sigurisë ushqimore, në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare dhe ligjet vendore të sigurisë ushqimore.

Menaxhimi i rrezikut të ndotësve të mjedisit PFAS

Menaxhimi i rrezikut të ndotësve të mjedisit PFAS ishte një temë e rëndësishme në trajnimin mbi udhëzuesit rregullativ të BE-së për sigurinë ushqimore. Diskutimi u përqendrua në rregullimin e kontaminantëve në ushqim, me një orientim të veçantë drejt reduktimit të ndotjes afatgjatë, duke patur parasysh se rastet e helmimit akut janë të rralla. Temat e trajnuara përfshijnë identifikimin e rrezikut shëndetësor të këtyre ndotësve, përfshirë efektin e tyre në sistemin imunitar dhe klasifikimin e tyre nga organizata ndërkombëtare si IARC dhe WHO.

Në kuadër të rregullatorëve të BE-së, u shqyrtuan iniciativat për kufizimin e PFAS dhe POP në ushqim, si pjesë e përpjekjeve për garantimin e sigurisë së konsumatorëve. Në përfundim, trajnimi u fokusua në përdorimin e rregullave dhe standardeve të BE-së për të adresuar dhe reduktuar rrezikun e ndotësve mjedisorë në ushqim, duke siguruar një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm për konsumatorët.

Paketa e higjienës së ushqimit

Tema mbi paketën e higjienës

nës së ushqimit u përqendrua në kërkesat higjienike të ushqimit me origjinë jo shtazore (U-OJSH), duke theksuar rrezikun mikrobiologjik në prodhimet e freskëta.

Diskutimet identifikuan mungesat në proceset e dezinfektimit dhe trajtimit të farave të mbira dhe tërfit si burime kryesore të kontaminimit, duke shkaktuar shpërthime të konsiderueshme të sëmundjeve ushqimore. Ndër të tjera, u vlerësua impakti i klimës dhe zinxhirëve të furnizimit në rritjen e shpërthimeve të sëmundjeve ushqimore të lidhura me frutat dhe perimet e freskëta.

Diskutimet theksuan nevojën për përmirësim në mënyrat e dezinfektimit të farave të mbira në fazën e prodhimit parësor, duke adresuar kontaminimin në burim. Gjithashtu, u diskutua për rëndësinë e trajtimit të farave të mbira dhe tërfit në fazën e përpunimit, duke përfshirë të gjitha praktikat e mira të higjienës për të minimizuar rrezikun e kontaminimit të kryqëzuar.

Në lidhje me këtë, u theksua roli i rregullativëve të BE-së për sigurinë ushqimore, duke përfshirë Rregulloren (EC) 852/2004 për higjienën e produkteve ushqimore, Rregulloren (EC) 2073/2005 për kriteret mikrobiologjike, dhe Rregulloren (EC) 853/2004 për higjienën e ushqimit me origjinë shtazore. Diskutimet u përqendruan në obligimet e operatorëve të biznesit ushqimor për të siguruar që të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimit përmbushin kërkesat e higjienës të përcaktuara në këto rregullore.

Përmes trajnimit mbi udhëzuesit rregullativë të BE-së për sigurinë ushqimore, UNIDO ka përcjellë tek pjesëmarrësit njohuri të rëndësishme dhe të nevojshme për të rritur përgjegjshmërinë dhe për të zbatuar standardet e sigurisë ushqimore në praktikën e tyre.

Rregullat dhe standardet e BE-së për ushqimin janë thelbësore për të garantuar shëndetin publik dhe sigurinë e konsumatorëve. Është e rëndësishme të kuptojmë dhe të respektojmë këto udhëzime në mënyrë që të sigurojmë që produktet ushqimore të jenë të sigurt, cilësore dhe të ofrojnë informacion të saktë për konsumatorët.



FINANCIM

Denaj takim me ambasadorin Bergner, projekte të përbashkëta në bujqësi

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj zhvilloi një takim me ambasadorin e Gjermanisë, në vendin tonë, Karl Bergner dhe atashen e Bujqësisë për vendet e Ballkanit, Frank Müller.

Denaj bëri të ditur se Gjermania mbetet një mbështetëse e madhe e zhvillimit të Shqipërisë dhe sektorit të bujqësisë.

“Përpos rritjes së bashkëpunimit midis dy qeverive për fuqizimin ekonomik të sektorit bujqësor dhe zhvillimin e zonave rurale, diskutuam edhe për krijimin e sinergjive të reja, të konkretizuara përmes projekteve të përbashkëta sikundër është ngritja në Shqipëri e Qendrës Rajonale të Informacionit GjeoHapsinor, i stacionuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës”, tha Denaj.

Denaj i shprehu ambasadorit Bergner, falënderime edhe në

në procesin e harmonizimit të ligjeve me Bashkimin Evropian, si edhe për shkëmbimin e

eksperiencës në fushën e modernizimit dhe digjitalizimit të bujqësisë, ku Gjermania është lider.



emër të qeverisë shqiptare për mbështetjen e vyer të qeverisë gjermane përmes asistencës teknike të ekspertëve gjermanë

eksperiencës në fushën e modernizimit dhe digjitalizimit të bujqësisë, ku Gjermania është lider.

Gonxhe: Garanci deri në 70% të marrjes së kredive për sektorin e industrisë përpunuese

Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Blendi Gonxhe bëri të ditur se Ga-

dueshëm me sektorin, miratuar garancinë sovranë për sektorin e fasonerisë me një

dhe mundëson financim për investime dhe kapital qarkullues, duke lejuar deri në 30% të financimit për blerjen e lëndës së parë”, u shpreh Gonxha në një postim në rrjetet sociale.

Ai theksoi se bizneset e sektorit të industrisë përpunuese do të kenë mundësi të aplikojnë për kredi me kushte lehtësuese.

Marrëveshja gjithashtu, shtoi ministri, kufizon normën e interesit për kreditë dhe standardizon tarifën nga bankat, duke sjellë stabilitet dhe siguri për bizneset.

Fasoneria ka një rol të rëndësishëm në punësim dhe eksporte. Skema synon të përmirësojë aksesin në financë dhe të promovojë investime në përmirësimin e teknologjisë, si dhe rritjes së nivelit të produktivitetit dhe konkurrueshmërisë.



rancia Sovrane për industrinë fason do të mundësojë financim për investime dhe kapital qarkullues.

“Pas një diskutimi të vazh-

dueshëm me sektorin, miratuar garancinë sovranë për sektorin e fasonerisë me një

Njohja e pensioneve, Hado: Gati marrëveshja me Serbinë, në proces me disa vende të tjera

Drejtori i përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Astrit Hado, në një intervistë për media, tregoi për vendet me të cilat synohet të arrihet marrëveshje për njohjen e pensioneve.

“Sigurisht që vijojnë përpjekjet. Përfunduar marrëveshjen kuadër me Serbinë. Javën tjetër ne do të shkojmë në Poloni dhe do të fillojmë negociatat. Pastaj, kemi në radhë Slloveninë, Spanja, presim nga Franca që të kemi dritën jeshile”, tha Hado.

Sipas tij, edhe Danimarka ka shprehur vullnetin për këtë proces.

Hado bëri të ditur se, gjithashtu po diskutohet me Holandën dhe vendet skandinave.



“Besoj sivjet mbyllim

Hado bëri të ditur se, gjithashtu po diskutohet me Holandën dhe vendet skandinave.

Serbinë dhe Slloveninë dhe do të startojmë me dy marrëveshje të tjera”, tha ai.

Hado vuri në dukje se, koordinimi skemës me vendet e Evropës, mbulon shumë shqiptarë dhe për më tepër kur sot, shq-

80% e kredive për fermerët jepen nga mikrofinanca, presidentja e shoqatës Muja: Për bujqësinë interesa të ulëta dhe pa kolateral

Mbi 38 milionë € kredi ka dhënë vjet sektori i mikrofinancës për sektorin bujqësor në vend. Presidentja e shoqatës Arlinda Muja tregon për Report TV se fermerët u drejtohen atyre për kredi për shkak të normave të favorshme të interesit, nuk kërkojnë kolateral dhe u caktojnë këste të favorshme për kthimin e huasë.

Institucionet financiare jo-banka janë kthyer në burimin kryesor të financimit për fermerët, të cilët për të zhvilluar biznesin e tyre, u duhet të marrin kredi. Më shumë se 38 milionë euro është vlera e kredisë që Mikrofinancat dhanë vitin e shkruar vetëm për bujqësinë.

“Mikrofinanca mbulon rreth 80% të financimeve që sot jepen nga sektori financiar për fermerët. Ajo që ne vëmë re është rritja e mesatares së kredisë për bujqësinë, që tregon se fermerët tanë po rriten. Nevojat e tyre për të investuar janë më të mëdha, ndoshta për shkak të rritjes së çmimeve, ndoshta për shkak të nevojës së rritjes së investimeve që marrin përsipër. I kemi ndihmuar për të kaluar në një fazë tjetër”, tha për Report TV, Arlinda Muja, Presidente e Shoqatës “Mikrofinanca Shqiptare” dhe njëkohësisht Drejtore e Përgjithshme e Kredo Finance.

Ajo thotë se normat e interesit po janë të favorshme për bujqësinë.

“Interesat e tyre nominale vjetore, variojnë nga 12% në 18%. Në të gjithë produktet që ofron mikrofinanca, kredia për bujqësi është më e lira, sepse kredia për bujqësi, mbështetet shumë edhe nga investitorët, që ofrojnë financim më të lirë për mikrofinancën. 12-18% janë norma shumë të lira, krahasuar me tregun financiar në vend, ajo që ndihmon bujqësinë është edhe nevoja për të pasur një grafik pagesash të



dedikuar sipas sezonalitetit të investimit që ata bëjnë”

Muja sqaron se këstet për kthimin e kredisë fermerëve ndryshojnë, në varësi të gjendjes financiare të fermerit.

“Ne ofrojmë këste shumë të ulta kur ju nuk keni të ardhura si fermer, dhe më pas kësti rritet në momentin e korrjes. E gjithë kjo bëhet në dakordësi me fermerin”, thotë Muja.

Për të marrë kredi pranë Mikrofinancës, nuk është kusht kolaterali, pasi i gjithë disburimin i huasë, bëhet mbi bazë të një analize që këto institucione bëjnë në terren.

“Kolaterali është lehtësia më e madhe që ne ofrojmë. Fermerët e kanë të pamundur të dokumentojnë të plotë pronësinë e tyre në një truall apo arë, dhe kjo e vështirëson aksesin e tyre në bankë. Ne marrim risk përsipër, është besimi, bëjmë analizë të thelluar fermerit në atë zonë, analiza jonë është e plotë. Kolaterali nuk do të ndi-

hmojë që ta paguaj kredinë, ajo që do të ndihmojë është në fakt besimi, eksperiencia për investimin dhe garancia për investimin që merr përsipër”

Muja shpjegon se vëmendja nuk është e përqendruar vetëm tek bujqësia.

“Ne i mbështesim të gjitha llojet e bizneseve. 52% e volumit të financimit është për bizneset. Në CREDO, ne ofrojmë kredi për biznes deri në 600 mijë lekë, dhe personave fizik që kanë një licencë të dedikuar për një profesion të lirë, apo për një biznes të vogël, por që kanë pronësi 100% si individ. Mikrofinanca ka qenë një mbështetje e mirë për të gjitha ato biznese që në rrugëtimin e tyre nuk e kanë pasur procesin në banka, sot janë biznese të mëdha”

Vetëm gjatë vitit të kaluar sektori i mikrofinancës ka disbursuar mbi 255 mijë kredi për 200 mijë klientë aktivë, me vlerë totale prej 147.8 milionë euro.

Fermerët e Myzeqesë përballen me luhatjet e çmimeve të shitjes së perimeve, një pjesë e prodhimit po u ngelet pa shitur

Fermerët në zonën e Myzeqesë shpesh herë përballen me luhatjet e çmimeve të shitjes për produktet bujqësore

Ata që po e ndjejnë me shumë këtë janë fermerët në fshatin Canakaj, që prej më shumë se 15 vitesh merren me kultivimin e perimeve në serra diellore.

Për ta, ky vit nuk quhet i suksesshëm, pasi prodhimi i kastravecëve po ngelet pa shitur. Këto dy familje kanë si burim kryesor ekonomik serat diellore. Mungesa e tregut dhe çmimi i ulët ka bërë që gjendja ekonomike e tyre të vështirësohet.

Çmimet e larta të inputeve bujqësore, plehtrat, rritja e çmimit të krahut të punës nuk e justifikon koston. Edhe pse kanë emigruar, këta të rinjtë janë kthyer për një jetesë më të mirë në vendin e tyre, por për t’a ky kthim nuk ka rezultuar i mbarë.

Të dëshpëruar nga kjo situatë, ashtu si fëmijët dhe prindërit e tyre, ndjehen të lod-



hur dhe shpesh herë mendojnë t’a braktisin.

Zona e Darsis, ku ndodhet dhe ky fshat është një nga zonat

më prodhuese, por politikat e ndjekura në fushën e bujqësisë nuk ka rezultuar frytdhënës

për banorët e kësaj zone, duke bërë që shumica e fermerëve ta braktisin bujqësinë dhe vendin.

INFORMACIONE

Gonxhe-Huber, firmoset marrëveshja për ngritjen e shkollës së ekselencës për Hoteleri-Turizëm në Tiranë

Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Blendi Gonxhe dhe ambasadorja e Zvicrës në Shqipëri, Ruth Huber nënshkruan një marrëveshje për

nënshkrua falë diskutimeve me Shkollën e Hotelerisë së Lozanës (EHL).

“Ky proces, i cili do të shtrihet në disa hapa duke nisur me

jenë pjesë e kësaj shkolle do të diplomohen sipas Diplomës Profesionale të njohur nga EHL”, nënvizoi Gonxhja.

Ministri Gonxhe tha se këtë projekt synojmë ta shtrijmë edhe në shkollat e tjera të vendit.

Duke cilësuar ambasadorën Huber një partnere të shkëlqyer të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Gonxhe tha se “me ambasadorën Huber diskutuam mbi ecurinë e projekteve të shumta në proces dhe mundësitë e bashkëpunimit të mëtejshëm midis dy vendeve tona”.

“Arsimi dhe formimi profesional, si kurrë më parë kanë sot vëmendjen tonë të plotë. Portofoli i gjerë i projekteve të bashkëpunimit midis Zvicrës dhe Shqipërisë në zhvillimin ekonomik, inovacionit, hapat e nevojshëm drejt një ekonomie më solide dhe formale, arsimin profesional dhe kulturë, ishin gjithashtu në fokus të bisedave”, tha Gonxhja.



zbatimin e një projekti, i cili ka në fokus ngritjen e shkollës së ekselencës në drejtimin e Hoteleri-Turizmit në Tiranë.

Gonxhe tha se marrëveshja u

formulimin dhe përshtatjen e programeve të studimit, e që do të plotësohet edhe me të gjithë infrastrukturën e nevojshme. Nxënësit dhe kursantët që do të

Tkurret bujqësia! Është sektori që punëson 1/3 e vendit. Sipas Bankës Botërore duhen më shumë subvencione

Ndërsa po lëngonte prej më se dhjetë vitesh, bujqësia u tkurr gjatë vitit 2023, treguan shifrat e rritjes ekonomike

Tkurja me -0.68% në sektorin bujqësor është një alarm kam-bane për sektorin që punëson 1/3 e vendit dhe jep deri në 27% kontribut në PBB-në e vendit.

Sipas ekspertëve kishte disa faktorë që sollën rënien evidente bujqësisë

“Goditja e parë erdhi për shkak të rritjes së kostos punëtore, aspekti dytë ishte aspekti i rënies së valutës së huaj me monedhën vendase, goditja e tretë ishte për arsyet të mbështetjes së qeverisë, pasi shpërtheu edhe bllokimi i fondeve IPARD, aspekti katërt ishte që një sektor si turizmi pati një rritje shumë të ndjeshme, por ti e shikon që turizmi duket si i zhvilluar me sektorët e tjerë të ekonomisë, në një vend tjetër turizmi, duhet të punonte në sinergji me këtë sektor dhe kontribuonte në zhvillimin e saj.”- shprehet eksperti i ekonomisë, Klodian Muço.

Banka Botërore në raportin e saj të fundit për Ballkanin Perëndimor evidentoi se Shqipëria i

ekonomi nëse 45% e ekonomisë jeton akoma në fshat dhe nuk e shikojnë me prioritet bu-



subvencionon fermerët më pak se të gjithë vendet e rajonit. Ekspertët ndajnë mendimin se pa mbështetje sektori do prodhojë edhe më shumë emigrim

“Nuk mund të zhvillosh një

jqësinë si sektor i së ardhmes në këtë gjendje që është me kaq copëzim. Po nuk u mbështet dhe po nuk u dhanë subvencione të rëndësishme, nuk do të zhvillohet kurrë.”

Bimët mjekësore stok në Malësinë e Madhe, Denaj: Takim me fermerët dhe grumbulluesit

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj u shpreh e gatshme për një takim mes fermerëve dhe grumbulluesve për adresimin e problemeve në sektorin e bimëve mjekësore në Malësinë e Madhe.

Duke marrë fjalën në seancën plenare të Kuvendit, në përgjigje të kërkesës së parashtruar nga deputeti i opozitës Ramadan Likaj, për zgjidhjen e problemit

të mallit stok të bimëve mjekësore në Malësinë e Madhe, Denaj tha se “jam dakord që ne ta bëjmë takimin, sidomos në Malësinë e Madhe ku keni ngritur shqetësimin për mallin stok”.

“Unë e kam marrë këtë shqetësim edhe nga takimet e mëparshme por absolutisht ne e konkretizojmë takimin me një ftesë konkrete dhe datë konkrete”, theksoi ministria.

Sipas saj, në diskutimin mbi mbarrëvatjen e kontratave mes fermerëve dhe grumbulluesve, ka një problem real që duhet të marrë një drejtim duke përfshirë edhe këta aktorë së bashku si pjesë e tryezës.

“Jam dakord që këtë ta bëjmë të plotë duke përfshirë dhe grumbulluesit që të adresojmë edhe çështjet e tyre në këtë diskutim”, tha ajo.

Prodhimi vendas nuk mjafton, importet e kafshëve të gjalla për mish u rritën me 62% në janar-mars

Importet e kafshëve të gjalla po tregojnë se sektori i blegtorisë në vend po përqësohet nga viti në vit.

Të dhënat nga tregtia e jashtme në tremujorin e parë të vitit 2024 tregojnë se importi i kafshëve të gjalla në sasi u rrit me 62%, teksa një vit më parë në këtë periudhë ndryshimi vjetor ishte 22%.

Të dhënat tregojnë se gati 30% e sasisë së kafshëve të gjalla vjen nga Greqia dhe thërrin për mish në Shqipëri.

Burimet nga tregu pohojnë se nga Greqia po importohen më së shumti derra dhe bagëti të imta për konsum mishi. Ndërsa numri i bagëtive për mbarrëshim, që zakonisht vijnë nga Holanda dhe Danimarka është krejt i ulët dhe gati në vlera të papërfillshme në krahasim me importet për mish.

Pas Greqisë, furnizuesit kryesorë të kafshëve të gjalla për mish janë Hungaria, Rumania, Kosova, Sllovakia dhe Maqedonia e Veriut. Kryesisht nga këto vende vijnë viça dhe të imta për mish.

Importet e kafshëve të gjalla për mish janë në rritje vit pas viti, por këtë vit tendenca ka qenë edhe më e fortë. Në njëerën anë, pakësimi i bagëtive në vend dhe në anën tjetër, turizmi, e kanë rritur kërkesën për mish.

Kulinaria shqiptare ka në themel të saj mishin, ndaj edhe rritja e numrit të turistëve nxit konsumin e tij në restorante. Por bashkë me konsumin është rritur edhe çmimi i mishit në mënyrë të ndjeshme. Në muajin mars, niveli i përgjithshëm i

çmimeve pësoi rritje vjetore me 2.3 %, ndërsa çmimi i mishit u rrit me 3.7%.

Vendi ynë kishte një traditë të pasur në mbarrëshimin e blegtorisë në natyrë, por me pakësimin e popullsisë në zonat e rurale, braktisjen e vendit nga të rinjtë dhe mungesën e subvencioneve kjo traditë po shuhet.

Përgjatë viteve 2021-2022 numri i krerëve ka pësuar rënie me rreth 20 për qind, teksa ashtu si edhe për njerëzit edhe për blegtorinë mungojnë të dhënat e sakta për krerët. Instituti i Statistikave ka shtyrë për vitin 2024 Censin e Bujqësisë i cili fillimisht ishte parashikuar për t'u zhvilluar në vitin 2022.

Përveç të tjerash blegtoria po përballet me konkurrence

Ai tha se fermerët e kanë kuptuar që sera te jep 2-3 mbjellje në vit, që edhe nëse humbjet në një kultivar fiton tek një tjetër. Vitet e fundit në zonat ku serat kanë përhapje masive numri i bagëtive ka shënuar rënie drastike.

Të dhënat e INSTAT tregojnë se, gjatë vitit 2022 rënia më e madhe vjetore e bagëtive të gjedhit, që janë edhe prodhuesit kryesor të qumështit dhe bulmetit, ishte më e lartë ishte në Belsh me 56 %, Mallakastër 55%, në Vorë 52%, Lushnjë me 46%, Shijak 45%, zona ku ka zhvillim intensiv të serrave.

Në Veri blegtorët po shesin lopët dhe po blejnë koshere. Psh në zonën e Tropojës krerët e gjedhit kanë rënë me 35% në



brenda sektorit të bujqësisë. Në zonat fushore, blegtorët konkurrohen nga serat. Për 1 hektar serrë të ardhurat arrijnë mesatarisht 40 mijë euro në vit, ndërsa për një lopë duhet një 1 hektar dhe fitohet 1000 euro në vit, analizon një zotërues i një ferme blegtorale në Fier.

pesë vitet e fundit, por numri i koshereve të bletëve po rritet me shpejtësi. Vitin e kaluar në bashkinë e Tropojës u numëruan 19,569 koshere me bletë me një rritje 22 për qind nga viti 2021 dhe 166 për qind nga viti 2018.

Revista “Monitor”

UBT dhe bashkia Përmet, ura të reja bashkëpunimi në fushën e bujqësisë

Universiteti Bujqësor i Tiranës vazhdon të zgjerojë gjithnjë e më tepër bashkëpunimin me institucionet vendore në vend, këtë herë duke nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit

zëvendëskryetari i bashkisë Përmet, Florand Hasani, firmosën marrëveshjen e bashkëpunimit, që synon ndërtimin e urave të reja të institucionalizimit të bashkëpunimit në

nga stafi i tij profesional mbi kryerjen e studimeve për rajonizimin e kulturave bujqësore në territorin e Bashkisë Përmet, praktikën më të mirë në përdorimin e tokës bujqësore, orientimin drejt bujqësisë organike, konsolidimin e kulturave bujqësore, reduktimin e erozionit dhe rreziqeve të tjera mjedisore, rehabilitimin e kanaleve vaditëse, menaxhimin e pyjeve dhe kullotave etj.

Rrektori dhe stafi i UBT e zhvendosën takimin e tyre edhe në gjimnazin “Sami Frashëri” të qytetit, ku zhvilluan një bashkëbisedim me objektiv informimin dhe këshillimin e maturantëve për të orientuar studimet e tyre të larta në degët e studimit të Universitetit Bujqësor.

Pjesë e turit që ka nisur rektori i UBT dhe stafi i tij për promovimin e UBT ishte edhe gjimnazi “Abaz Shehu” në Tepelenë.



me bashkinë e Përmetit.

Rrektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës prof. dr. Fatbardh Sallaku dhe

fushën e bujqësisë.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje UBT do të ofrojë trajnime, seminare, workshope

Potenciali i turizmit si një shtytës i zhvillimit rural

Shqipëria vitet e fundit ka përjetuar një rritje të ndjeshme të turizmit falë bukurive të saj natyrore, peizazheve, biodiversitetit dhe një tradite të pasur kulinare me produkte të ndryshme bujqësore.

Kjo rritje është shoqëruar nga politika të qeverisë që promovojnë ruajtjen e burimeve natyrore dhe biodiversitetit. Një shembull i kësaj përpjekjeje është krijimi në vitin 2023 i parkut kombëtar të lumit të egër Vjosa, i pari i këtij lloji në Evropë që mbrohet nga Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN).

Në vitin 2020, industritë e lidhura drejtpërdrejt me turizmin kontribuan me 3.1 përqind i në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB), ndërsa kontributi i përgjithshëm i sektorit - duke përfshirë efektet nga investimet dhe zinxhiri i furnizimit - ishte rreth 17 përqind, sipas Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit. ii

Flukset turistike hyrëse u dyfishuan në më pak se një dekadë, nga 4 milionë në 2016 në 8.4 milionë në janar-tetor 2023. Të dhënat e INSTAT-it tregojnë se mbi 10 milionë shtetas të huaj kanë hyrë në vend në vitin 2023. iii, iv

Ekonomia vendase dhe infrastruktura e Shqipërisë po stimulohen për të përmbushur kërkesën e këtij numri në rritje turistësh që kërkojnë prodhime më të shumta vendase në nivel sasi dhe cilësor, dhe shërbime të ngjashme. Nxitja e sektorit të agroturizmit është një mënyrë për të adresuar këtë kërkesë, duke krijuar mundësi të reja tregu, duke shfrytëzuar potencialin e tij si nxitës i zhvillimit rural.

Shumica e objekteve të agroturizmit në Shqipëri bazohen në modelin nga ferma-në-pirun, me ferma të pajisura edhe me restorante që ofrojnë kuzhinë tradicionale. Ruajtja e agrobiodiversitetit, mbrojtja e bimëve autoktone dhe promovimi i praktikave të qëndrueshme dhe tradicionale të prodhimit bujqësor dhe ushqimor janë bërë pjesë integrale e qasjes së agroturizmit.

Promovimi i agroturizmit të qëndrueshëm midis konsumatorëve urbanë do të katalizojë zhvillimin e sistemeve ushqimore që ofrojnë ushqime ushqyese të rritura nëpërmjet metodave miqësore me mjedisin, duke gjeneruar gjithashtu mundësi për të nxitur zgjerimin ekonomik dhe për të përmirësuar të ardhurat dhe jetesën në zonat rurale.



Informimi i vizitorëve për varietetet lokale të perimeve të rritura në fermën Lile në fshatin Katundishtë gjatë një dite të hapur në gusht 2023. ©FAO

Hendeku rural-urban

Megjithatë bujqësia jep një kontribut të rëndësishëm në ekonominë kombëtare, duke zënë 19.3 përqind v të PBB-së dhe 33.8 përqind v të normës totale të pu-

Histori suksesi - Shqipëria: investimi në agroturizëm si një motor për prosperitetin e përbashkët

Përdorimi i një qasjeje sistemesh për të kapërcyer hendekun rural-urban dhe siguruar sisteme ushqimore të barabarta, elastike dhe të qëndrueshme

nësim, pjesa më e madhe e prodhimit ekonomik të Shqipërisë gjenerohet nga qytetet e saj. Në 2022, Tirana dhe Durrësi, dy qytetet më të mëdha, kontribuan përkatësisht me 43 për qind dhe 10 për qind në PBB. Në përgjithësi, prodhimi urban është rreth 11 herë më i madh se prodhimi rural, ndërsa popullsia që jeton në qytete është vetëm 1.3 herë më shumë se ajo që jeton në fshat.

Infrastruktura dhe fuqia e mjaftueshme e punës janë të pamjaftueshme në zonat rurale, ku rreth 85 përqind v të tokës së kultivuar të vendit përbëhet nga ferma të vogla familjare, me një sipërfaqe mesatare prej 1.2 hektarësh. Këto kufizime i shtojnë të rinjtë dhe të rejtat të migrojnë në qytete ose vende të tjera në kërkim të mundësive ekonomike.

Gjithashtu, popullsia e plakur në ferma po lufton për tu përshtatur me risitë teknologjike dhe ndryshimin e preferencave të konsumatorëve, dhe pavarësisht rasteve shembullore të agrosipërmarrësve që modernizojnë praktikën e tyre të prodhimit, shumica e produkteve të kultivuara në vend ende përballesh me sfida në përmbushjen e standardeve të sigurisë dhe cilësisë gjatë transportit dhe tregut.

Vizioni i Shqipërisë për ndryshim

Për të mbushur boshllëkun rural-urban dhe përpara Samitit të OKB-së për Sistemet Ushqimore 2021, Qeveria Shqiptare zhvilloi një rrugë kombëtare që parashtron vizionin e saj për të ardhmen: një nga prosperitetet e përbashkëta e nxitur nga përpjekjet kohezive nga të gjithë aktorët e sistemeve ushqimore për të përmirësuar jetesën rurale, sigurinë dhe produktivitetin ushqimor, ofrimin e ushqimit të sigurt dhe cilësor që promovon shëndetin dhe mirëqenien e konsumatorit dhe të rrisë kapacitetin e vendit për t'u përshtatur me ndryshimet klimatike.

Për ta arritur këtë, rruga kombëtare parashtron një sërë prioritetesh për dekadën e ardhshme: zhvillimin e agroturizmit dhe zinxhirët e shkurtër të vlerës si shtytës të zhvillimit rural; për të

zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Pse një qasje sistemesh për të trajtuar sfidat e agroturizmit?



Gratë fermere nga një grup i krijuar prodhimi të cilat shfaqin produktet e rritura dhe të përgatitura në fermat e tyre të agroturizmit gjatë një festivali tradicional në Katundishtë në gusht 2023. ©FAO

Agroturizmi përfshin një qasje sistemesh pasi bashkon shumë sektorë të ndërlidhur: bujqësinë, turizmin, infrastrukturën, marketingun, ushqimin, kulturën dhe ekonominë lokale.

Qasja e sistemeve ka të bëjë me bashkimin e sektorëve të ndryshëm, palëve të interesuara dhe disiplinave për të arritur në një kuptim të përbashkët të pengesave kryesore për të ndryshuar, si dhe mundësitë e shfaqura për rritje, si dhe për të hartuar dhe zbatuar së bashku një sërë veprimesh të ndërlidhura që mund të arrijnë rezultate të shumëfishta.

Këto rezultate përfshijnë diversifikimin e sipërmarrjes, marketingun e produkteve ushqimore vendase, promovimin e bujqësisë miqësore me mjedisin, ruajtjen e biodiversitetit lokal dhe traditave ushqimore, fuqizimin e grave si menaxhere të agrobiznesit, rritjen e njohurive bujqësore dhe më shumë.

Një qasje sistemesh nënkupton gjithashtu parashikimin dhe zbutjen e pasojave të mundshme të paqëllimshme, të tilla si ndikimi i rritjes së fluksit turistik tek banorët vendas dhe burimet natyrore, ose konkurrenca midis fermave ose bizneseve të tjera të lidhura.

Mbështetja e Shqipërisë për të kapërcyer hendekun rural-urban



Gratë fermere marrin pjesë në seminarin e Fed Invest/Qendfra ABA mbi përmirësimin e prodhimit të vajit të ullirit. ©ABA Online

Duke filluar nga viti 2022, FAO, përmes Nismës së Siste-

meve të Qëndrueshme të Ushqimit në Mesdhe (SFS-MED), mbështeti Shqipërinë në tranzicionin e saj, duke përdorur një qasje sistemesh.

Si hap i parë, projekti SFS-MED organizoi dialogjet lokale në bashkitë Belsh, Përmet dhe

Shkodër, duke mbledhur së bashku sipërmarrës të agroturizmit, fermerë burra dhe gra, institucione mikrofinanciare, përfaqësues të bashkive, ofrues të shërbimeve të ekstensionit bujqësor dhe institute të trajnimeve profesionale, duke përfshirë shkollat e kuzhinës.

Së bashku, ata reflektuan mbi sfidat dhe mundësitë, dhe identifikuan mënyra për të përmirësuar agroturizmin shqiptar nëpërmjet bashkëpunimit në sektorët dhe disiplinat e tyre përkatëse. Qëllimet kolektive ishin të gjeneronin të ardhura dhe të prodhonin ushqime më të larmishme, në mënyra miqësore me mjedisin.

Dialogët krijuan një hapësirë të sigurt dhe gjithëpërfshirëse në të cilën pjesëmarrësit ndjeheshin të dëgjuar dhe të fuqizuar për të shprehur shqetësimet dhe idetë e tyre në një platformë të njohur publikisht. Ato nxitën veprimtari të reja midis aktorëve të ndryshëm për të kuptuar dallimet e tyre, për t'u angazhuar në dialog kuptimplotë dhe për të eksploruar se si mund të bashkëpunojnë në mënyrë më efektive.

Për shembull, një nga rezultatet që doli nga këto dialogje ishte nevoja e një bashkëpunimi të ngushtë midis shkollave profesionale, bizneseve agroushqimore dhe komuniteteve rurale për të pajisur të rinjtë vendas me aftësitë në zhvillimin e veprimtarive agroushqimore të së ardhmes.

biznesi, por atyre u mungon përvoja dhe mundësitë e financimit për të filluar biznese”, komenton pjesëmarrësi i dialogut Eldi Ceco. Ai drejton Qendrën ABA, e cila ofron shërbime këshillimi biznesi për fermerët, si dhe një platformë online për seminare, trajnime dhe demonstrime praktike në terren.

Në të njëjtën kohë, ky proces tregoi se si proceset në nivel kombëtar mund të bazohen në realitete territoriale, me përgjegjshmëri më të madhe në nivel lokal. Falë këtyre dialogëve, pjesëmarrësit bashkëpunuan për të formuluar të dhënat e tyre në një udhërrëfyes kombëtar për transformimin e sistemeve ushqimore, duke për-



Fermerët ndjekin sesionin e trajnimit për prodhimin e fidanëve të perimeve dhe menaxhimin e sëmundjeve. ©FAO

dorur agroturizmin si pikë hyrëse.

Udhërrëfyesi përfshin skema të përmirësuar të drejtave mbi tokën, trajnime të detyrueshme për të garantuar cilësinë e shërbimit dhe standardet mjedisore, mbështetjen për markën e lidhur me etiketat e origjinës dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike nëpërmjet, energjisë së rinovueshme, pyllëzimit dhe përdorimit të varieteteve bimore rezistente ndaj thatësisirës.

Ky vizion kolektiv u nda me qeverinë në një konsultim kombëtar që u bashkëkryesua nga Zëvendësministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Koordinatori i Përhershëm i OKB-së dhe Përfaqësuesi i FAO-s në Shqipëri. Në konsultim morën pjesë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si dhe përfaqësues nga akademitë, operatorët e biznesit agroushqimor, shoqëria civile, agjencitë qeveritare dhe OKB.

“Ndërhyrjet që dëgjua sot konfirmuan se agroturizmi është prioritet dhe konsiderohet si një mjet për transformimin e sistemeve ushqimore, duke pasur parasysh rëndësinë e turizmit dhe bujqësisë për ekonominë tonë. Sistemet ushqimore të Shqipërisë mund të transformohen nëse jemi në gjendje të inovojmë, përmes partneriteteve të reja, teknologjive të përmirësuar dhe modeleve arsimore krijuese”, tha Irfan Tarelli, Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Përfaqësuesi Kombëtar i Samitit të Sistemeve Ushqimore të OKB-së në Shqipëri.

“Si një fushë ndërsektoriale, agroturizmi mund të na ndihmojë të koordinojmë përpjekjet midis institucioneve të ndryshme.

I mirëpres platformat si dialogu i sotëm dhe dialogët e ndryshëm që i paraprijnë këtij të fundit, të cilat ndihmojnë në bashkimin e të gjithë palëve të interesuara dhe udhëzimin e tyre drejt prioritetit të çështjeve të shumta dhe dimensioneve të qëndrueshmërisë. Platforma si këto mundësojnë një bisedë dhe komunikim të vazhdueshëm ndërmjet agjencive publike, donatorëve, shoqërisë civile dhe operatorëve të biznesit”, shtoi ai.

Ky proces theksoi rëndësinë e ndërtimit të konsensusit gjithëpërfshirës për të stimuluar bashkëpunimin midis palëve të interesuara. Ai tregoi gjithashtu rëndësinë e lehtësimit të lidhjeve ndërmjet njerëzve, sektorëve dhe niveleve të qeverisjes për të gjetur një ndjenjë të përbashkët drejtimi që bazohet në kontekstin lokal.

Trajnime të përbashkëta përmes grupeve (clusters) dhe më shumë

Projekti SFS-MED gjithashtu lehtësoi trajnime të përbashkëta dhe mundësoi rrjetëzimin përtej takimeve të ndryshme. Për shembull, ai pilotoi një nga veprimet e identifikuar në udhërrëfyesin kolektiv, duke bashkuar një grup sipërmarrësish të agroturizmit në një grup prodhimi për të përmirësuar metodat e tyre, cilësinë e produktit dhe për t'u lidhur me fermerat fqinj për të plotësuar prodhimin e njëri-tjetrit.

Kjo u arrit duke lidhur sipërmarrësit e agroturizmit me agronomët, një OJQ lokale e quajtur Programi për Mbështetjen e Shoqatave Rurale, dhe një bankë farash. Anëtarët e grupit, të vendosur në zonën e Përmetit, morën trajnime mbi praktikën e qëndrueshme bujqësore, duke përfshirë përdorimin e reduktuar të ujit dhe pesticideve, kompostimin organik dhe ujitjen me pika, dhe u mbështetën për të organizuar ditë të hapura në fermerat e tyre në një përpjekje për të arritur klientë në mënyrë kolektive në vend të praktikës individuale.

Këto ditë të hapura ishin të rëndësishme në vendosjen e lidhjeve midis furnitorëve ruralë dhe konsumatorëve urbanë, duke rritur ndërgjegjësimin për bujqësinë e qëndrueshme, varietetet e bimëve dhe produkteve ushqimore lokale.

Në një shembull tjetër, projekti SFS-MED organizoi një vizitë studimore në rajonin jugor të Pulias të Italisë, ku sipërmarrësit shqiptarë të agroturizmit mësuuan se si kolegët e tyre italianë kombinonin bujqësinë organike me turizmin, duke ofruar kuzhinë tradicionale të

BUJQËSI

Shfrytëzimi i potencialit të bujqësisë shqiptare - nga fusha në financim

Sektori bujqësor në vend ka potencial të konsiderueshëm dhe mundësi për të krijuar dhe për të maksimizuar vlerë të shtuar. Qasja në tregje fitimprurëse do të sillte rritjen e flukseve hyrëse të të ardhurave në vend

menaxhimin e dijes.

Pengesë tjetër e madhe vjen nga aftësitë prodhuese

trale. Kjo mund të sjellë konflikt ndërmjet pretendimeve për pronësi, duke shtuar më tej pasiguritë.

Përmirësimi i cilësisë së të dhënave ekzistuese për tokën është element kritik. Të gjitha të dhënat për tokat bujqësore dhe ato kadastrale duhet të regjistrohen me mjete dixhitale, si dhe duhet të hartohet një hartë kadastrale dixhitale unike për përdorim nga rilesuesit, agjencitë qeveritare dhe autoritetet vendore.

Gjithashtu, në këndvështrim afatgjatë, është e nevojshme t'i kushtohet vëmendje e përgjyeshme formimit të brezit të ri të profesionistëve të tokës në lidhje me metodat moderne të regjistrimit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tokës.

Përmirësimi i qasjes në financim

Megjithatë sektori i bujqësisë kontribuon me rreth 20% të PBB-së, sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë, sektori përfiton më pak se 3% të së gjithë huadhënies nga bankat.

Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë rurale nuk ka qasje në institucione formale financimi, ndërkohë që vetëm më pak se një e treta e tyre ka llogari bankare, ndërsa më pak se një e pesta e ndërmarrjeve të vogla kanë hua bankare ose linjë kredie.

Si pasojë, kapitali i pamjaftueshëm qarkullues rezulton në cilësi të ulët të farërave, mekanizim të kufizuar dhe nivel të ulët përdorimi të plehrave kimike për hektar, duke dëmtuar më tej prodhimtarinë.

Shqipërisë i mungojnë instrumente të tilla si dëftesa tregtare për produktet bujqësore, apo sigurimet bujqësore.

Ofrimi i skemave të garancisë së kredisë dhe instrumenteve alternative financiare, si dhe krijimi dhe nxitja e tregjeve të sigurimit të produktit bujqësor dhe ndaj rreziqeve klimatike, zbusin rrezikun e huadhënies, duke sjellë në këtë mënyrë zgjerimin e qasjes në financime, veçanërisht për fermerët e vegjël.

Integrimi në zinxhirin e vlerave të BE-së

Procesi i anëtarësimit në Bashkimin Europian (BE) ka forcuar lidhjet e Shqipërisë me tregjet kryesore europiane, ku ato marrin 71,5% të eksporteve bujqësore dhe ushqimore, ndërsa ofrojnë 62,4% të importeve.

Fatkeqësisht, eksporti në vendet e BE-së ka pësuar rënie në terma relativë, ndërsa ato drejt Serbisë dhe vendeve të tjera fqinje në rajon kanë shënuar rritje.

Zakonisht, tregjet e BE-së ofrojnë çmime më të larta sesa ato të Ballkanit Perëndimor, e megjithatë eksportet shqiptare drejt BE-së kufizohen kryesisht në mallrat pak të përpunuara me nivele të ulëta të shtimit të vlerës.

Me qëllim integrimin më të mirë në zinxhirin europianë bujqësorë të vlerave, Shqipëria duhet të zgjidhë vështirësitë e veta ndërsektoriale, sidomos ato që lidhen me qasjen në tokë, në financim, infrastrukturë dhe logjistikë, si dhe të sigurojë përmbushjen e standardeve të sigurisë ushqimore dhe kërkesave të certifikimit.

Fuqizimi i standardeve ushqimore, sistemeve të certifikimit, gjurmueshmërisë dhe përmirësimi i infrastrukturës janë elemente kyçe për

prodhimin dhe do të nxisin diversifikimin e sektorit.

Rehabilitimi i infrastrukturës së ujitjes do të përforconte aftësinë ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike dhe fenomeneve natyrore. Gjithashtu, përmirësimi i procedurave doganore dhe procedurave të tjera në kufi do të



anëtarësimin në BE dhe për zgjerimin e qasjes në treg.

Autoritetet shqiptare duhet të analizojnë kërkesat rregullatore mbi eksportin e pemëtarisë dhe produkteve të tjera ushqimore dhe të hartojnë planet përkatëse për ngritjen e kapaciteteve të prodhuesve vendas.

Në të njëjtën kohë, ato duhet të përmirësojnë kapacitetet mbikëqyrëse të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, të ngrenë laboratorë të akredituar për analizimin e eksporteve, si dhe mekanizma certifikimi, dhe të investojnë në platforma informacioni me qëllim për t'u komunikuar fermerëve dhe palëve të tjera të interesit kërkesat sanitare dhe fitosanitare.

Trajtimi i mangësive infrastrukturore

Investimet në infrastrukturën rrugore, përmirësimi i qasjes në zonat rurale dhe përmirësimi i infrastrukturës së nevojshme pas korrijës apo vjeljes, në përputhje me kërkesat ndërkombëtare të certifikimit, do të sillnin shtimin e

ulte kostot e eksportit dhe do të fuqizonte konkurrueshmërinë e produkteve shqiptare në tregjet e huaja.

Udhërrëfyesi për të ardhmen

Vendimmarrjet politike dhe ndërhyrjet e suksesshme në katër fusha kyçe, që mund të rezultojnë në një fazë të re të transformimeve strukturore në bujqësinë shqiptare, janë:

- zgjidhja e fragmentimit të tokës dhe e të drejtave të pronësisë

- përmirësimi i qasjes në infrastrukturë, ujitje dhe transport

- përmirësimi i standardeve dhe certifikimit të ushqimit, së bashku me infrastrukturën përkatëse

- forcimi i lidhjeve sektoriale për konkurrueshmëri më të mirë në eksport

Sektori bujqësor në vend ka potencial të konsiderueshëm dhe mundësi për të krijuar dhe për të maksimizuar vlerë të shtuar. Qasja në tregje fitimprurëse do të sillte rritjen e flukseve hyrëse të të ardhurave në vend.

Revista "Monitor"



të madhe të eksporteve të përgjithshme, me 11.3% të eksporteve gjithsej.

Pavarësisht rritjes së qëndrueshme të prodhimit bujqësor gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, Shqipëria vijon të mbetet pas vendeve fqinje.

Pengesat në dukje të qarta që e pengojnë përparimin përfshijnë fragmentimin e tokës, investimet e pakta në infrastrukturë dhe shërbime rurale, të drejtat e pasigurta të pronësisë mbi tokën, qasjen e kufizuar në financim dhe mungesën e dijeve dhe aftësive që kanë të bëjnë me tregun.

Hapësirat rurale të Shqipërisë janë të ndara në rreth 359.000 ferma me sipërfaqe mesatare prej rreth një hektar, sipërfaqe që shpesh është e ndarë në parcela edhe më të vogla.

Shkalla e lartë e fragmentimit të tokës sjell drejtpërdrejt prodhimtari të ulët, pasi fermerët nuk janë në gjendje të shfrytëzojnë ekonominë e shkallës në prodhim, logjistikë, informacion për tregun dhe për

të kufizuara, që sjell si pasojë vijimin e përdorimit joefektiv të inpueteve dhe proceseve bujqësore, duke ulur kështu më tej nivelin e prodhimtarisë së fermës shqiptare.

Modernizimi i menaxhimit të tokës

Aktualisht, vetëm 10% e titujve të pronësisë mbi tokën është e regjistruar në mënyrë dixhitale, ndërsa 80% është e regjistruar vetëm në format shkresor. Dhjetë për qind e tyre nuk janë të regjistruara fare.

Mungesa e titujve të pronësisë dhe dokumentacionit mbi tokën ua vështirëson qasjen në financim fermerëve, duke përkeqësuar më tej situatën e financimit të pamjaftueshëm dhe duke shtuar rreziqet që lidhen me kapitalin e pamjaftueshëm qarkullues.

Për më tepër, vetëm dokumentacioni i regjistrimit nuk përbën provë të plotë pronësie, për shkak të mospërputhjeve ndërmjet të dhënave të regjistrimit dhe atyre kadas-

Siguria ushqimore, vetëm 5% e qumështit që prodhohet në vend testohet

Vetëm 5% e blegtorëve kryejnë teste laboratorike për cilësinë e qumështit thotë një studim i FAO-s që u publikua këto ditë. Gjetjet kanë treguar se Shqipëria ka nivelin më të ulët të kontrollit të cilësisë së qumështit në rajon.

Në Shqipëri, vetëm 5.5% (200) e fermerëve të anketuar pohuan se kanë përdorur shërbimet e testimit të qumështit gjatë vitit 2020, ndërsa në Bosnjë dhe Hercegovinë, 16.7%. Të dhëna për Serbinë dhe Malin e Zi, që i takojnë vitit 2021, tregojnë se 19.9% e fermerëve serbë dhe 42.1% e fermerëve malazezë bënë testimin e qumështit në vitin 2021.

Studimi evidenton se cilësia e qumështit cenohet pasi fermerët përziejnë mjeljet e mungjesit dhe pasdites dhe kjo është e dëmshme sidomos kur qumështi nuk është ruajtur në mënyrë të papërshtatshme.

Më shumë se 40% të fermave të të imtave në Serbi dhe në Malin e

Zi përziejnë qumështin e mungjesit dhe të pasdites, ndërsa edhe 25% e fermerëve në Bosnjë dhe Shqipëri



e bëjnë këtë përzierje.

Pothuajse në të gjithë rajonin, shumica e të imtave milen me dorë. Kjo mënyrë siguron kushte higjienike të kufizuara dhe komprometon standardet e sigurisë së qumështit.

Gjithashtu prania e ujit në zonën e mjeljes është një element i rëndësishëm për të siguruar mini-

mumin e kushteve higjienike, por 75% e fermerëve të të imtave pohojnë se jo gjithmonë kanë ujë të



pijsshmën në vendet e mjeljes.

Fermat e të imtave në përgjithësi nuk zbatojnë praktika të menaxhimit të fermës, të tilla si pasja e një regjistri të kafshëve, identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve, mbajtja e shënimeve, kostot dhe të ardhurat, dhe nuk përdorin shërbimeve këshillimore.

Nëse zbatohen këto praktika,

fermat e të imtave me shumë gjasë mund të rrisin performancën e tyre në mënyrë që të blejnë mjelëse elektrike.

Disa fermerë thanë se mungesa e aksesit në energji elektrike në stallat apo stane e bën të pamundur përdorimin e makinave mjelëse. Të tjerët thanë se nuk kishin mundësi të blinin një të tillë.

Fermerët e vegjël shqiptarë të të imtave fokusohen kryesisht në prodhimin e qumështit, ndërsa homologët e tyre në Serbi, Mal të Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë priren drejt prodhimit të mishit.

Sektori i deleve dhe dhive përballlet me disa sfida, duke përfshirë mungesën e fuqisë punëtore, çmimet e ulëta dhe fonde të pamjaftueshme për investime.

Për sa u përket preferencave të politikave, fermerët e deleve dhe dhive vlerësojnë masat mbështetëse të drejtpërdrejta, të tilla si pagesat për kokë për mjeljen e ripërtypësve të vegjël.

“Një Shtet, Një Produkt Prioritar”, Denaj: Fokus, gështenja e Tropojës

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj mori pjesë në takimin e dytë online me temë “Një Shtet, Një Produkt Prioritar” (OCOP), së bashku me drejtorin e përgjithshëm të FAO-s, Qu Dongyu, përfaqësues të tjerë të organizatës dhe anëtarë të komitetit drejtues, mbajtur në kryeqytetin italian, Romë.


Denaj tha se, Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO) është një partner i rëndësishëm për bujqësinë shqiptare.

Sipas saj, në takim disku-

tuan lidhur me ndërtimin e zinxhirëve më të fortë të vlerave ushqimore për Produktet Bujqësore Speciale (SAP) në Shqipëri.

Ministrja infomoi se gjatë takimit, u fokusua në prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e gështenjes në Tropojë, si një nismë konkrete që po zhvillohet me hapa të qëndrueshëm.

“Së bashku ndihmojmë në pakësimin e ndikimeve negative të ndryshimeve klimatike, rrisim qëndrueshmërinë e bujqësisë dhe forcojmë sistemet agroushqimore”, tha Denaj.



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO

PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



INFORMACIONE

Lançohet për konsultim Strategjia e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024-2030

Ministria e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Delina Ibrahimaj lançoi për konsultim Strategjinë e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative për vitet 2024-2030. Ky dokument, i hartuar në bashkëpunim me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, përfaqëson vizionin për të rritur potencialin e sipërmarrjes dhe inovacionit në vendin tonë.

Strategjia stimulon rritjen e ekosistemit të startup-eve dhe zhvillimin e të gjitha shtresave të ekosistemit, duke përfshirë nivelin mikro, të mesëm dhe atë makro, dhe gjeneron qarqe të virtutshme brenda ekosistemit dhe sektorëve me prioritet ekonomik në vend.

Ministria e Sipërmarrjes dhe Klimës së Biznesit, Delina Ibrahimaj nënvizoi se kjo strategji hedh themelet për ndryshimin e krijimit të vlerave kombëtare të Shqipërisë, duke trajtuar tre shtyllat: Ekosistemi Inovativ Sipërmarrës, Sektorët Strategjik (S3), si dhe Zhvillimi Gjithëpërfshirës.

“Përmes mbështetjes institucionale dhe investimeve të përshtatshme, synojmë të ndërtojmë një mjedis të favorshëm për sipërmarrjen dhe inovacionin. Bashkëpunimi i aktorëve të ndryshëm, përfshirë qeverinë, sipërmarrësit dhe komunitetin akademik, korporatat dhe kapitalin privat, do të jetë thelbësor për suksesin e kësaj strategjie dhe zhvillimin ekonomik të vendit”, deklaroi ministria e Sipërmarrjes dhe Klimës së Biznesit, Delina Ibrahimaj.

Ky dokument parashikon një sërë masash dhe veprimesh për të adresuar sfidat dhe mundësitë e ekosistemit sipërmarrës në tërësi. Në qendër të kësaj strategjie është rritja dhe fuqizimi i rolit të sipërmarrësit, përmes nxitjes së inovacionit, zhvillimit të tal-

kërkon lidhshirësin e gjithsecilit prej jush, kërkon lidhshirësin e startup-eve, kërkon lidhshirësin e sipërmarrjes që ekziston në vend me qëllim mbështetjen e inovacionit dhe bashkëpunimit, hapjen e horizontit dhe të dyerve për bashkëpunim me start up-et, pasi vetëm

fund të muajit Prill 2024 me qëllim përmblidhjen e nevojave dhe të synimeve të të gjithë palëve të interesuara, duke përfshirë sipërmarrësit, akademikët, përfaqësuesit e qeverisë, sektorin privat, dhe shoqërinë civile.

“Deri në fund të prillit do të kemi të hapur konsultimin pub-

sur. Vetëm duke bashkëpunuar mirë në hartimin e strategjisë dhe planit të veprimit ne do të arrijmë të shfrytëzojmë maksimalisht potencialin që kemi, qoftë të atij njerëzor, atij financiar, por edhe potencialin për të shkruar përtej kufijve dhe për të ndërkombëtarizuar ato ide që ne mund të kemi

Drafti i strategjisë u prezantua nga Emri Dzaniç, ekspert inovacioni, Niko Slavniç, autor i librave mbi financimet alternative, sipërmarrës dhe profesor nga Shkolla e Biznesit BLED, Slloveni, i cili prezantoi eksperiencat Sllovene dhe racionale në ngritje të ekosistemit.

Në panelin e diskutimit me temë “Iniciativat ekzistuese në mbështetjen e inovacionit në ekonominë shqiptare dhe drejtimin strategjik të ekosistemit për Shqipërinë 2030” morën pjesë Emanuel Salinas, drejtor i Zyrës së Bankës Botërore në Shqipëri, Rigela Gegprifti, drejtore e përgjithshme Devoll Hydropower, Gazmend Haxhia, sipërmarrës dhe investitor.

“Kur i hedhim një sy ekonomisë shqiptare, gjatë viteve të fundit shohim që ajo është zhvilluar, është kthyer në një ekonomi të zhdërvjellët, ku kemi një sektor privat shumë proaktiv dhe që ka një potencial shumë të madh dhe mendojmë që për potencialet që ka duhet të shfrytëzohet edhe më shumë dhe ne jemi këtu për të ndihmuar me eksperiencën tonë në këtë drejtim”, tha Salinas.

“Ne shohim këtu një mundësi të madhe, ku edhe pse është një fushë e re, vërejmë që Shqipëria ka ecur shumë përpara me strategjinë e vet, veçanërisht në fushën e digjitalizimit”, vuri në dukje Gegprifti.

Ndërsa sipërmarrësi Gazmend Haxhia tha se zhvillimi i sipërmarrjes në vitet e fundit ka ndryshuar shumë dhe ka ecur përpara.



enteve vendase, krijimit të ambienteve të përshtatshme për rritje dhe zhvillim, si dhe mbështetjes së financimit dhe politikave të përshtatshme për sipërmarrjen.

“Strategjia është një dokument shumë i rëndësishëm dhe sigurisht që është qeveria që e merr lidhshirësin e hartimit të saj dhe mbështetjes së çdo hallke që kemi parashikuar aty. Zhvillimi i strategjisë dhe arritja e objektivit

bashkë do mund të arrijmë ato fazat e zhvillimit të shpejtë të saj. Kërkon padiskutim mbështetjen e akademisë, pasi janë studentët dhe akademika, e cila do të na ndihmojë me ide të reja, produktive dhe të strukturuar që do t'i shërbejnë ekonomisë tonë dhe asaj globale”, vuri në dukje ministria Ibrahimaj.

Çdo kontribuues do të mund të ofrojë sugjerime për të përmirësuar dokumentin deri në



lik, do të bëjmë takime të këtij lloji dhe më të vogla, e më të strukturuar që çdo grup interesi të ketë mundësi të shprehë mendimet e veta. Presim që edhe nëpërmjet e-mailit dhe komunikimeve elektronike gjithsecili prej jush të japë mendimet për çdo element të strategjisë që duhet të zhvillohet ndryshe, apo përmirësuar atë mendim që ne kemi pa-

për të ardhmen”, bëri me dije ministria Ibrahimaj.

Sipas saj, kjo strategji paraqet një platformë të qëndrueshme dhe të qartë për të ndërtuar një ekonomi inovative dhe të qëndrueshme në Shqipëri, duke i dhënë vendit tonë mundësinë për të qenë pjesë e një të ardhmeje më të më të qëndrueshme dhe konkurruese globalisht.

Histori suksesi - Shqipëria: investimi në agroturizëm si një motor për prosperitetin e përbashkët

(Vijon nga faqja 6)

bazuar në përbërësit me burime vendase.

Vizita përfshiu gjithashtu takime me përfaqësues nga Qeveria vendore Italiane dhe agjencitë e zhvillimit, të cilët ilustruan rëndësinë e një mjedisi të favorshëm legjislativ dhe institucional në mbështetje të bashkëpunimit midis sipërmarrësve të agroturizmit.

Çfarë ka filluar të ndryshojë



Turistët e huaj vizitojnë stendën me prodhime vendase të ekspozuara gjatë një dite të hapur në fshatin Katundishtë, Këlcyre, Përmet. ©FAO

Për shumë pjesëmarrës, dialogjet lokale dhe kombëtare shënuan takim e tyre të parë për të diskutuar mbi sistemet agroushqimore. Kjo i motivoi ata të dilnin nga sektorët e tyre të veçantë dhe të parashikonin shtigje të reja drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

“Mësova se sipërmarrësit e agroturizmit duhet të veprojnë si udhërrëfyes për fermerët në zonën e tyre: si të prodhojnë, çfarë të prodhojnë dhe kur do të nevojitet. Pra, ata duhet të

kombinojnë biznesin e tyre me bizneset e vogla familjare që i rrethojnë”, komenton Ceco nga Qendra ABA.

“Kjo ndodh tashmë, por është sporadike; Ne duhet ta shtyjmë këtë qasje më shumë si një model biznesi, sepse ka potencial agroturizmi kudo në zonat rurale të Shqipërisë”, shton Ceco.

Ferma dhe restoranti i familjes Lile është një shembull i një lideri të virtutshëm në zonën e saj lokale, e cila ndodhet pranë Banjovë Termale të Bënjës në Parkun Kombëtar të Lumit

“Blejme produkte nga fermerët e tjerë – qumësht, djathë, patate, vezë kur nuk i kemi”, rrëfen Fabja Lile, 18 vjeç.

Familja Lile mori mbështetje nga RASP, e cila ofroi trajnime mbi teknikat e ujitjes, reduktimin e përdorimit të pesticideve, kompostimin, rrjetëzimin me fermerë të tjerë dhe rritjen e dukshmërisë së tyre përmes etiketimit dhe ekspozimit të produkteve të tyre në panairë.

“Ata na ndihmuan jo vetëm me gjëra materiale si ndërtimi i një sere në mënyrë që të mund të kultivojmë perime gjatë gjithë vitit – ata gjithashtu na ndihmuan të zgjerojmë idetë tona”, thotë Fabja.

“Deri këtë vit, prindërit e mi e drejtonin biznesin e tyre të gjithë vetë. Nuk e dinim që kjo lloj ndihme ishte në dispozicion. Tani jemi më shpresëdhënës dhe më të hapur për të mësuar nga organizata të tjera”.

Një ndryshim tjetër domethënës është krijimi, brenda Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i një departamenti të agroturizmit, i lidhur me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për të zbatuar veprime të përbashkëta, për të cilat udhërrëfyesi kolektiv mund të bëhet shtylla kryesore.

Perspektiva për të ardhmen

Aktivitetet pilote të SFS-MED kanë treguar se kur fermerët e vegjël dhe agro-sipërmarrësit përshtasin praktika të përmirësuar të prodhimit dhe biznesit dhe bashkëpunojnë në grupe, ata mund të hyjnë në tregje më fitimprurëse dhe të ofrojnë produkte më të sigurta dhe me cilësi më të lartë.

Reagimet nga terreni tregojnë



Turistët dhe fermerët vjelën së bashku varietetet lokale të perimeve nga kopshti në fermën Lile. ©FAO

se aktorët reagues shumë pozitivisht: jetesa e tyre u përmirësua dhe metodat e tyre u bënë më të qëndrueshme.

Për të mbështetur transformimin e vazhdueshëm, ka nevojë për përpjekje të vazhdueshme për të përdorur një qasje sistemesh duke lidhur palët e interesuara nga sektorë të ndryshëm për të kapërcyer vështirësitë, si në nivel politikash ashtu edhe në terren. Kjo do të kërkojë identifikimin e kampioneve me dukshmëri kombëtare dhe lokale, të cilët mund të ofrojnë lidhshirësin dhe avokim.

Gjithashtu, bisedat me ministritë dhe agjencitë vendore të financimit janë në vazhdim për të

mobilizuar burimet për të zbatuar disa nga prioritetet në udhërrëfyesin kolektiv. Këto përfshijnë ngritjen e grupeve midis tregut të Tiranës dhe fermave të vogla agroturistike që ofrojnë produkte të sigurta vendase.

Një ide tjetër është të promovohen zgjedhjet e zgjuara klimatike, e lidhur në mënyrë dixhitale për të mbrojtur biodiversitetin malor dhe për të përmirësuar jetësinë e barinjve dhe komuniteteve të tyre përmes itinerareve turistike.

Rreth SFS-MED

Nisma SFS-MED është një forum për dialog dhe bashkëpunim shumëpalësh, një rr-

jet për forcimin e shkëmbimit të njohurive dhe ndërtimit të kapaciteteve, si dhe një katalizator për bashkëpunimin rajonal mbi temat prioritare për transformimin e qëndrueshëm të sistemeve agroushqimore në Mesdhe.

Qëllimi i tij është të krijojë një komunitet për të shfrytëzuar dhe ndarë njohuritë, përvojën dhe aftësitë e aktorëve të sistemeve agroushqimore në të gjithë rajonin e Mesdheut, ndërsa zbatohen përpjekjet rajonale, kombëtare dhe lokale për transformimin e sistemeve ushqimore më të qëndrueshme.

Financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Italisë, SFS-MED është një partneritet midis Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO), Qendrën Ndërkombëtare për Studimet e Avancuara Agronomike Mesdhetare (CIHEAM), Sekretariati i Unionit për Mesdheun (UfM) dhe Partneriteti për Kërkim dhe Inovacion në Zonën e Mesdheut (PRIMA). Është një projekt i lidhur me Programin e Sistemeve të Qëndrueshme të Ushqimit të Rrjetit One Planet.

ⁱ INSTAT. 2022. Tourism in Figures Albania 2021. Tiranë, INSTAT. <https://www.instat.gov.al/media/11112/tourism-in-figures-albania-2021.pdf>

ⁱⁱ USAID. Fact Sheet: Support for Tourism Development. USAID. <https://2017-2020.usaid.gov/albania/news-information/fact-sheets/fact-sheet-support-tourism-development>

ⁱⁱⁱ INSTAT. 2024. Tourism Statistics. In: INSTAT: Institute of statistics. INSTAT. <https://www.instat.gov.al/en/themes/industry-trade-and-services/tourism-statistics/#tab2>

^{iv} Euronews Albania. 2024. Albania outperforms all European countries in overnight stays. In: Euronews Albania. <https://euronews.al/en/albania-outperforms-all-european-countries-inovernight-stays/>

^v INSTAT. 2022. Produkti i Brendshëm Bruto, 2020. Press release. INSTAT. <https://www.instat.gov.al/media/9739/produkti-i-brendshem%3C3%ABm-bruto-final-2019-dhegjysm%3C3%AB-final-2020.pdf>

^{vi} INSTAT. 2021. Tregu i Punës 2020. Press release. INSTAT. <http://www.instat.gov.al/media/8293/njoftim-per-median-tregu-i-punes-2020.pdf>

^{vii} FAO. 2020. Smallholders and family farms in Albania. Country study report 2019. Budapest. <https://doi.org/10.4060/ca7450en>

KËNDI I MBROJTJES INTELEGJENTE TË BIMËVE

Mbrotjtja biologjike e bimëve nga insektet dëmprurës në bujqësi

Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrotjtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

Prof. Ass. Enver Isufi,
Agronom në Mbrotjtjen e Bimëve
dhe Bujqësinë Biologjike

Ç'është mbrotjtja biologjike?

Me bimët dhe prodhimet bujqësore nuk ushqehen vetëm njerëzit dhe kafshët, por me bimët e produktet e tyre ushqehen një numër shumë i madh specimesh të insekteve dhe sëmundjeve.

Vetë këto insekte dhe sëmundje kanë kundërshtarët e tyre. Një mori insektesh dhe mikroorganizmash ushqehen mbi trupin e insekteve dhe mikroorganizmave të tjera.

Pikërisht insektet dhe mikrorganizmat, të cilët ushqehen mbi insektet e dëmshëm në bujqësi, ne i konsiderojmë insekte dhe mikrorganizma të dobishme, sepse ata sulmojnë ato parazitë, të cilët sjellin dëm në bujqësi. Meqenëse këto insekte të dobishme dhe mikroorganizmat janë të gjalla dhe jo substanca kimike, kjo mbrotjtje ka marë emrin "Mbrotjtja Biologjike"

Dy janë grupet e mëdha të formave të dobishme në mbrotjtjen e biologjike.

1. INSEKTET E DOBISHME

2. MIKROORGANIZMAT E DOBISHME

Grupi i parë, INSEKTET E DOBISHME, sipas mynyrës se si ushqehen mbi prënë, (insektin e dëmshëm) ndahen në dy nëngrupe specimesh:

a. Insekte të cilët konsumojnë direkt fizikisht insektet e dëmshëm, ku në këtë rast thirren edhe insekte të dobishëm grabitqarë (ose predatorë)

b. Insekte të cilat parazittojnë mbi trupin insekteve ose larvave të këtyre insekteve dëmtues të bimëve. Këto quhen insekte të dobishme parazitare, sepse ushqehen brenda trupit të presë.

Grupi i dytë, MIKROORGANIZMAT E DOBISHME, të cilët parazittojnë mbi insektet e dëmshme. Këto nga ana e tyre bazuar në natyrën e mikroorganizmave ndahen në tre nëngrupe.

a. Me bazë bakteriesh, b. Me bazë kërpudhore, c. Me bazë virusesh.

Të gjitha këto grupe gjallesash ndodhen në natyrë, por shumë nga speciet ose shtamet e tyre rriten e shumohen në biofabrika, ku paketohen për t'u tregtuar dhe përdorur si mjete mbrotjtjeje në nivel ferme.

Tani po i përshkruajmë pak më gjatë këto organizmave të dobishme

1. Grabitqarët e insekteve të dëmshëm, (Predatorët)

Siç thamë më sipër, janë insekte të cilët ushqehen direkt mbi insektet e dëmshëm duke i kafshuar e gëlltitur ato. Të tilla janë mollakuqet që ushqehen me morrat e bimëve, larva e syartës (chrysopës) (Chrysopa carnea), e cila ushqehet mbi larvat e fluturave, këpushat, larvat e krahëbardhës etj. Grabitqarë ose predatorë janë ujqit që hanë delet, skifteri që hanë shpendët etj.

• Shembuj të insekteve të dobishme që ushqehen si grabitqarë (predatorë)

Këta janë grupi i insektve të familjes Coccineliadae (psh, familja e mollekuqeve me ngjyra dhe madhësi të ndryshme)


Këto predatorë të dobishëm ushqehen me morrat, breshkëzat, këpushat e bimëve.

(Fotot nr. 1 dhe 2)

Specie të tjera të familjes coccineliadae, ngrënës të afideve, këpushave, breshkëzave etj.



Larva dhe insekti i rritur i mollëkuqes duke ngrënë afidet e bimë



Këpusha e perimeve (Tetranychus urticae) duke u ngrënë nga predator (Phytoseilus persimilis)



Larva e predatorit (Chrysopa cornea) duke u ushqyer me një afid të bimëve)



Predatori (Colosoma sycophanta) duke u ushqyer me një larvë future, e cila dëmtom gjethet e pemëve.

Insektet e dobishme, të cilat ushqehen si parazitë mbi trupin e insekteve të dëmshëm

Këto insekte i lëshojnë vezët e tyre mbi insektin e rritur, mbi vezët ose mbi larvën e insekteve të dëmshme. Këto larva rriten duke u ushqyer në trupin e stadeve të insektit të dëmshëm, duke e konsumuar atë plotësisht.

Fotot të cilat ilustrjnë shembuj se si ushqehen insektet parazitare, (Foto nr. 3).

• Në foton e parë sipër matas shikohet insekti dobishëm duke vendosur vezën e tij brenda insektit të dëmshëm, konkretisht afidit të grurit.

• Poshtë kësaj fotoje shikohen afidet (morrat e grurit) tashmë të dëmtuara. Me organet e bredshme të afidit është


nga larvat e parazitit. Këto larva kanë dalë nga vezët e parazitit futura me vezë vendosen mbrenda larvës së madhe të isnektit dëmtues.

Insektet parazitare bëjnë pjesë në shumë rende dhe familje insektetsh dhe kanë forcë të madhe në paksimin e popullatave të insekteve të dëmshëm në natyrë. Shumë nga këto specie që ndodhen



Në skicën e mëposhtme (Foto nr. 4) përshkruhet cikli që zhvillon paraziti Encarsia mbi larvat e krahëbardhës. Shikojmë insektin e Encarsias që po vendos vezën brenda trupit të larvës krahëbardhës. Pastaj duket larva Encarsias duke u ushqyer me larvën e krahëvardhës.

Larva e Encarsias është rritur dhe po kthehet në pupë mbrenda larvës së madhe dhe pupës së krahëbardhës. Pas këtij stadi shikojmë insektin e Encarsias, e cila po del nga trupi i larvës dhe pupës së krahëbardhës.



Në skicën e mëposhtme (Foto nr. 5), një shembull tjetër se si një insekt i dobishëm paraziton mbi larvat dëmtuese të një fluturë.

Skica e mëposhtme (Foto nr. 6) ilustron parazitimin e larvave të dëmtuesve nga nematodot.

Nematodot janë krimba të rrumbullakët, me pamje që të kujtojnë askaridet te njerëzit dhe kafshët, por që janë shumë të vogla. Këto nematoda ushqehen mbi trupin e insekteve të rritur ose mbi larvat e tyre.

Ka disa biofabrika në botë, të cilat i rrisin këto nematoda dhe i tregtojnë fermave bujqësore, si produkte për mbrotjtjen biologjike të bimëve.

Çfarë duhet të dimë për mbrotjtjen dhe shtimin e insekteve të dobishëm në mbrotjtjen e bimëve?

a. Përkujdesja për popullatat e insekteve të dobishme, të cilat gjenden në natyrë.

• Popullatat e predatorëve dhe parazitëve, të cilat janë në mjediset bujqësore dhe jashtë tyre duhen mbrotjtur duke shmangur produktet e mbrotjtjes së bimëve (PMB-t), helmuese për to.

• Të lemë oaze ekologjike me larmi biologjike, me lulëzim sa më të gjatë vjetor, për shtimin e insekteve të dobishme. Këto insekte ushqehen me polenin e luleve të bimëve spontane.

• Mbajtja e pemëtoreve, vreshtave, ullishte me koridore të gjelbërt dhe me biodiversitet.

b. Përkujdesja për insektet e dobishme që rriten në biofabrika

Kur në mbrotjtjen e bimëve përdoren insekte të dobishme të prodhuara nga biofabrikat dhe prej këtej hidhen në fusha na duhet të dimë këto elemente:

• Duhet të dimë mirë se paraziti natyral që do të përdorim sa efektiv është ndaj insektit që do të mbrohemi.

• Duhet ditur koha kur duhet të hidhen insektet e dobishme në serra ose në fushë, sepse duhet të përkojë me atë stad të dëmtuesit që preferon të ush-

qehet insekti i dobishëm.

• Duhet njohur shkalla e infeksionit të serrës ose fushës nga dëmtuesi, që të përcaktojmë numrin e insekteve të dobishme që duhet të shpërndajmë për njësinë e sipërfaqes.

Duhet të llogarisim mirë se sa herë do të përsëriten shpërndarjet e insekteve të dobishme në sipërfaqet që duam të mbrojmë.

• Nuk duhet të përdorim insekticide, të cilat vrasin insektet e dobishme që kemi shpërndarë.

Cilat janë vështirësitë e zbatimit në nivel ferme e mbrotjtjes biologjike?

• Kjo praktikë mbrotjtjeje kërkon një kulturë biologjike dhe ekologjike, në kuptimin që të njihen mekanizmat se si rregullohen popullatat e insekteve në natyrë.

• Kërkon një përvojë që të fitohet besim te kjo metodë mbrotjtjeje. Efekti i mbrotjtjes biologjike nuk shikohet siç duken insektet e ngordhura nga një insekticid.

• Ka vështirësi në furnizimin me këto insekte të dobishme nga firmat prodhuese, sepse duhen ruajtur mirë gjatë transportit, ruajtjes në vendin ku do përdoren. Këto insekte duan disa kushte ruajtje, sepse janë organizma të gjalla dhe ngordhin, ose kalojnë me kohë në faza të tjera zhvillimi, të cilat nuk mund të hidhen në fushë.

• Ka vështirësi në gjetjen e treg të produkteve të mbrotjtjes së bimëve, të cilat nuk janë helmuese për insektet e dobishme.

(Vijon nga faqja 11)

Mbrojtja biologjike e bimëve nga insektet dëmprurës në bujqësi



Megjithatë, këto vështirësi me kohë kalohen dhe hap pas hapi kjo metodë ekologjike mbrojtjeje bëhet praktikë e zakonshme për fermerët.

Është një fakt i mirë që Ministria e Bujqësisë ka dhënë disa lehtësira për importimi e insekteve të dobishme, të cilat për-

doren për mbrojtjen e perimeve ndaj krahëbardhës së serrave dhe ndaj këpushës së zakonshme në perime.

Është koha për të ecur shumë më shpejt me këtë metodë miqësore mbrojtjeje, sidomos kur tani janë rritur kërkesat për cilësi, si kon-

sumatorit vendas dhe atij jashtë Shqipërisë që shfaqet me shtimin e kërkesa në rritje për produktet bujqësore shqiptare. Produktet pa mbetje kimikatesh, gjithmonë janë e do të jenë më të kërkuarat nga konsumatori, por dhe nga mjedisi në përgjithësi.



Një libër me poezi, të titulluar “Thellësia e thjeshtësisë”, me autor Prof. Ass. Dr. Enver Isufi, më solli ndërmend një sentencë e thënë nga një filozof, konkretisht nga amerikanë Eriç Hoffer (1902-1983), se “s’është aspak e thjeshtë të kuptosh gjërat e thjeshta.” Nuk mund të them me plot gojën që kjo gjë, pra të mos kuptoja filozofinë e poetit Enver Isufi në poezitë e shkruara prej tij në një mënyrë krejt origjinale, por ndjesia se ky autor është disi ndryshe nga të tjerët, se tematika dhe fabulat aq të thjeshta e tokësore, që ai sjell përpara lexuesit me një gjuhë ezopiane, zuri vend në të gjithë qenien time shpirtërore dhe emocionale.

Aty kuptova se autori është një gatim tjetër, që komunikim me njerëzit nëpërmjet poezisë e ka parë si detyrim, por më së shumti ka marrë përsipër që mendimet më të thella t’i paraqesë tek lexuesi në mënyrën më të thjeshtë të mundshme. Libri në 350 faqe, përmbledh me dhjetëra poezi të shkruara në vitet (2012-2020), të cilat janë grupuar në pesë kapituj, të ndarë sipas një tematike të menduar mirë, siç janë vjershat për meritokracinë, ato shoqërore e psikologjike, të atdhedashurisë, të mjedisit e të ekonomisë dhe portretizimin e disa personaliteteve kombëtare në vargje poetike. Për çka është shkruar me përgjegjësinë e poetit “autodidakt” lexuesi gjen rast të ngelet gojëhapur për faktin sesi një specialist i fushës së bujqësisë të mund të arrijë të shkruajë aq bukur, të mund të ketë gjetur gjuhën universale të poetëve e që zemrën ta bëjë pjesë të natyrës dhe të problemeve që i qëndrojnë brenda vetes. Rast pas rasti në këtë libër, Enver Isufi na shfaqet në poezitë e tij mjeshtër i fjalës së

Gjuha ezopiane në poezinë e poetit të bujqësisë Enver Isufi

(Opinion letrar nga Bashkim Koçi, gazetar i bujqësisë dhe publicist)



gjetur, me të cilat ai, si ato tullat që ngrehjnë ngrehina e palate shumëkatëshe, ka gjetur mënyrën e vendosjes, të lidhura me hekur e beton, për ta bërë poezinë unike, sipas projektit të shqyrtuar e të miratuar me mendjen e tij të angazhur tërësisht për të na sjellë poezi të gatuar posaçërisht për ata që e njohin bukurinë e poezisë.

Edhe një lexues i “velur” me poezi, kur përballet me krijimet e Enver Isufit nuk ka si të mos relaksohet me fantazinë e tij, t’i rehatohet shpirti me figurat e gjetura dhe logjikën, që ai ka vënë në punë për të sjellë diçka të gjallë, diçka që lëviz e merr frymë, si të jetë një gjallesë. Autori i vëllimit me poezi “Thellësia e thjeshtësisë”, e ka arritur suksesin edhe sepse ai ka ditur të jetë i kujdesshëm në përdorimin e fjalës, të urtësisë së saj për të mbijetuar në kujtesën e lexuesit. Ai është përpjekur të ruhet nga banalitetet, nga fjalët e zbrazëta, nga ato që është mirë të mbeten pa thënë, por nuk ka harruar që

të gjitha vjershat në këtë vëllim poetik të përshkohen nga të qenët i çiltër, i hapur, i gatshëm për t’i dhuruar lexuesit entuziazëm dhe ca më shumë bukuri estetike. Fjala për poetin është madje si një plumb që, nëse e mban shënjestrën keq, në vend që të vrasësh skifterin, vret pëlumbin. Enver Isufi gjen rastin të japë edhe një këshillë, e cila është dhënë e thënë si një gjetje nga fusha e bujqësisë, andej nga ai ka rrugëtuar për të gjetur shpëtimin e poetëve, “Zgjidh mirë fjalët para se ti nxjerrësh, /Siç zgjidhen farërat përpara se t’i mbjellësh”, ngre shqetësimin ky poet, të formuluar e shprehur si të ish Ezopi. Tek poezitë e Enver Isufit gjen rastin të njihesh me poezi që të fisnikërojnë, që të ngacmojnë ndjenjat dhe të rrëmbejnë si dallgë deti frymëzuese. Çuditërisht vjershat e tij janë disi të veçanta, që shprehin mendim të thellë, por i shfaqur në mënyrën më të thjeshtë. Çfarë do të ishin librashkruesit pa lexuesit?-pyet poeti. Dhe

përgjigjet fare thjeshtë, fare bukur: “Librabërësit janë si kuzhinierët;/ Për shijen dhe vlerën e gatimeve, duhen pyetur të tjerët.” Kështu poeti na e pasqyron botën që e rrethon në mënyrë krijuese me anë figurash artistike të gjetura dhe të menduara mirë, me përgjegjësinë se është duke u njohur si krijues e vjershëtor përpara lexuesit të kualifikuar, me shije e me sqimë. Për poetin Enver Isufi nuk ka asgjë më të thellë se ajo që shfaqet në sipërfaqe. Ai këtë e ka bërë të lexueshme, të prekshme gati në të gjitha poezitë e vëllimit “Thellësia e thjeshtësisë”, shumica e të cilave janë në trajtë fabulash. Në disa poezi fjalët janë ezopike dhe kanë kuptim alegorik, japin mësim nga përvoja e jetës, të cilën, pra jetën, Enver Isufi e ka bërë dhe e bën të plotë, si askush tjetër. Duke ushtruar profesionin e agronomit, të një specialisti të mirënjohur në shkallë kombëtare, ai edhe tematikën e poezive e ka shumë të larmishme,

të gjetura e mblojtura si perla të mendimit të urtë njerëzor. Janë një numër i madh poezi-fabula, të cilat hollë-hollë janë historia e punës së autorit, që të lënë të kuptosh se ato janë fotokopje e shpirtit dhe botëkuptimit progresist të tij, sa të thjeshtë po aq edhe të ndërlikuar.

Qoshen e këtij vëllimi poetik e zënë gjëra të singerta, pa asnjë lloj ndërlikimi dhe ca më shumë që vijnë nga brenda shpirtit të poetit. Nëse do të shpreheshim në mënyrë figurative, strumbullari i të gjithë kësaj krijimtarije është singleriteti i fabulistit vjershëtor Enver Isufi, zbehtësia e të cilit mos prit që të të çfaqet në ndonjë strofë a rrjesht të poezive. Në vëllimin me poezi “Thjeshtësia e thellësia” një lexues i vëmendshëm nuk e ka të vështirë të konstatojë faktin se autori nuk duron dot hosanatë, zakonen për t’ju lënë vend të pamerituar kotësirave, duke mbajtur qëndrim të palëkundur e serioz, në mënyrë që e rëndësishmja të dalë në dukje, të ngjisë dhe të bëhet mish e gjak për atë që e lexon. Nga kjo pikëpamje poeti na shfaqet progresist, i aftë e novator për të vënë në dukje të mirën, atë që herë-herë nuk gjen shqisë tjetër që të ndjehet e të shihet. Dhe të gjitha këto detaje në krijimtarinë e Enver Isufit shfaqen edhe sepse ai është njeri i singertë, i ndershëm, dhe kur kërkon të thotë diçka nëpërmjet vargut poetik, e thotë në mënyrën më të vërtetë të mundshme. Tek poezitë e autorit në këtë vëllim ndjehet diçka që të çon tek mendimi se ato janë produkt i çasteve frymëzuese të poetit, por edhe tek qëndresa dhe vendosmëria

e tij për të guxuar të pushtojë territoret të panjohura, nga ata që u përkasin vetëm poetëve. Për t’ju futur këtij “profesioni”, por edhe për të mbetur i zënë vendi që i takon në ushtrinë e poetëve, Enver Isufi gjeti forcë për të provuar veten, duke kaluar edhe “bankëprovën”, atë të ustait të poezisë, Dritëro Agollit.

Dritëroi, pasi u njoh me krijimet e tij, nuk nguroi të thoshte me urti e dashamirësi, ashtu çiltërsisht, siç dinë të komunikojë poeti me poetin:

Vjersha të tilla duken të thjeshta, por duan kulturë për t’i kuptuar.

Shkruaj për çfarë mendon dhe ashtu siç i mendon. Pas këtij momenti magjik Enver Isufi, ashtu si një Ezop i vërtetë, nuk ndaloi së shkruari poezi e fabula, subjektin e të cilave i ka patur dhuratë nga jeta e tij aktive, nga dashuria e tij për punën dhe për njerëzit. Duke e ditur çfarë dëshironte dhe duke patur forcë për t’ju futur një rrugë krejt të re, të pashkelur, munda të gjente kurajon edhe për ta bërë tashmë, siç dëshiron të thotë vet poeti Enver Isufi, - libri është “pakëtuar” bukur, i mbushur me krijime, fabula e poezi, të gatshme për “marketing” te lexuesit. Enver Isufi thotë - botimet e formave, madhësive, gjinive të ndryshme, janë paketimet e mendimeve të autorëve, ashtu si të gjitha mallrat e tjera në tregun e madh.

Enver Isufi, ka respekt për lexuesin. Ai u përulet lexuesëve duke iu drejtuar “Për ju lexues të nderuar, fjalët dhe vargjet duhet servitur si arrë e qëruar” “Vargjet duhen shtrirë në atë thellësi të pusit, ti arrijë kova e lexuesit”

Për këtë nga ky poet pa bujë, lexuesi nuk del me “kovë bosh”, por plot me ujë.

Pamja e qiellit gjatë muajit maj 2024

Më 6 dhe 7 maj - Dushi mete-
orik Eta Aquarids. Eta Aquarids
është një shi mbi mesataren, i aftë

Parashikimi i motit për muajin maj 2024 në Tiranë (Zona bregdetare)

Dt.	Temperatura e ajrit °C		Temp. reale që ndjehet °C	Shiu		Era				UV Indeks	Zhvillimi i reve dhe reshjet	Simboli
	U	L		mm	Orë	Km/Orë		Drejtimi				
						D	N	D	N			
1	11	21	10/21/2020	1.0	2	7	6	JL	VVL	3	Kryesisht me re	
2	13	21	12/21/2021	2.5	4.5	4	6	JJL	LJL	2	Vranësirë me ndonjë shi me pika	
3	15	21	15-21-21	8.8	6.5	6	2	LVL	JL	2	Periudhë me shira	
4	15	21	14-22-21	2.6	4.5	6	6	VL	VVP	2	Mbetet vranësirë me ndonjë shi të vogël	
5	14	22	13-25-21	9.0	5	7	7	VVL	V	6	Intervale re dhe kohë e mirë,një shi në mëngjezi ndjekur nga një stuhi pasdite	
6	15	22	14-25-20	0	0	7	9	VVL	V	6	Intervali reeve dhe kohë me diell	
7	12	22	13-27-21	0	0	7	7	VVL	V	9	Kryesisht me diell	
8	12	22	13-26-21	0	0	7	6	VL	V	9	Diell i bollshëm	
9	13	23	13-27-22	0	0	6	4	JL	VVP	9	Kryesisht me diell	
10	13	24	14-23-22	8.5	3	9	7	JJL	JJL	3	Kryesisht vranësirë me disa shira dhe stuhi pasdite	
11	13	23	14-27-21	0	0	7	6	JJL	V	8	Pjesërisht me diell	
12	13	22	12/27/2021	0	0	6	7	VL	V	9	Kryesisht me diell	
13	15	23	14-23-23	5.2	3	7	4	VL	VL	3	Vranësirë me disa shira pasdite	
14	15	23	15-24-23	7.9	4	4	4	VL	JJL	3	Disa shira në mëngjes pastaj plot me re	
15	15	23	14-26-22	2.4	1.5	6	7	JJL	J	7	Një shi kalimtar në mëngjes, pastaj periudhë me vranësira dhe kohë me diell	
16	16	23	14-27-22	3.4	1	9	9	JJL	J	8	Diell dhe pak re	
17	14	23	15-26-22	4.1	2	7	6	J	JJP	5	Një stuhi në mëngjes, pastaj interval resh dhe kohë e mirë	
18	13	23	13-27-22	0.5	0.5	7	7	JJL	J	8	Pjesërisht me diell me ndonjë shi në kalim pasdite	
19	14	22	13-22-20	18,6	7	9	6	JL	LJL	2	Vranësirë me pasdite me shira dhe stuhi	
20	14	22	15-23-21	6.4	4.5	6	6	V	V	3	Vranësirë me disa stuhi	
21	15	23	13-26-22	1.7	1	6	7	LVL	VVP	5	Kohë me re dhe diell	
22	14	24	15-27-22	0	0	7	7	VL	V	8	Pjesërisht me diell	
23	16	24	17-28-23	2.8	1	7	4	VL	L	10	Kryesisht me diell	
24	17	26	17-28-25	8.5	4	6	6	VL	V	5	Një përzierje diell dhe re,me disa shira dhe stuhi pasdite	
25	17	25	16-29-24	2.2	1	6	6	VL	VVL	8	Pak diell	
26	18	25	16-28-25	9,1	3,5	7	4	VL	L	7	Periudhë me re dhe diell me stuhi me pika pasdite	
27	17	27	17-28-25	2,0	2	9	6	PVP	VVP	10	Diell dhe pak re me ndonjë stuhi në zone	
28	17	27	17-29-16	2,5	2	9	7	VP	VVL	9	Interval i re me diell me disa shira dhe stuhi, kryeisht vonë	
29	16	26	16-30-26	4,6	3	6	9	VVL	LVL	9	Kohë me re dhe diell me disa stuhi	
30	16	26	15-30-26	9,2	6	4	4	JJL	JJL	8	Kohë me re dhe diell me disa stuhi	
31	17	27	17-29-25	3,4	2	7	6	JP	PJP	10	Kohë me re dhe diell me disa stuhi, sidomos herët në mëngjes	

Treguesit mesatarë klimatikë gjatë muajit maj 2024

Treguesit	Tiranë	Korçë	Vlorë	Shkoder	Dibër	Gjirokastrë
Temperatura e ajrit						
Mesatare (°C)	21	17	21	21	14	17
Maksimale (°C)	23	20	22	24	19	20
Minimale (°C)	18	14	20	18	9	13
Më e larta gjatë viteve (°C)	34 (2020)	29 (2009)	30 (2018)	33 (2009)	28 (2009)	32 (2020)
Më e ulta gjatë viteve (°C)	9 (2016)	5 (2011)	12 (2011)	8 (2010)	-5 (2011)	4 (2009)
Numuri i ditëve me Temperatnë + 30°C (Ditë dhe %)	1 (3)	0	0	2 (6)	0	0
Numuri i ditëve me Temperat në + 18°C (Ditë dhe %)	29 (94)	21(68)	29 (94)	29 (94)	18 (58)	21 (68)
Numuri i ditëve me Temperat në -0°C (Ditë dhe %)	0	0	0	0	1 (3)	0
Era						
Shpejtësia e erës (Km/Orë)	14	12	19	12	11	12
Temperatura e erës (°C)	18	13	20	18	8	13
Reshjet (Shiu)						
Shi (mm)	157	161	96	128	214	152
Numuri i ditëve me shi (Ditë dhe %)	9 (30)	9 (30)	5 (16)	6 (20)	12 (38)	9 (30)
Sasia rekord e shiut gjatë një dite (mm dhe vit)	63. 7 (2010)	67. 7 (2012)	72. 6 (20190	87. 9 (2010)	100. 3 (2010)	61. 5 (2010)
Dëborë (cm)	0	0	0	0	0	0
Lagështia e ajrit (%)	70	76	69	66	77	70
Shikueshmëria (Km)	9. 48	8. 73	9. 73	9. 48	8. 84	9. 38
Mbulimi i qiellit me re (%)	25	33	22	26	34	26
UV index	6	5	6	6	4	5
Orë me diell neDitë	14	14	14	14	14	14
Gjatësia e ditës (Orë)	14:13	14:27	14:27	14:35	14:33	14:24
Vlerësimi i muajit	Mirë	Mirë	Mirë	Mirë	Mesatare	Mirë

e hershme vendase amerikane si Hëna e Luleve, sepse kjo ishte koha e vitit kur lulet e pranverës shfaqeshin me bollëk. Kjo hënë është njohur edhe si Hëna e Mbijelljes së Misrit dhe Hëna e Qumështit.

Parashikimi i motit për muajin maj 2024

Maji në Tiranë do të ndikohet nga klima bregdetare mesdhetare. Maji është një nga muajt më të mirë të vitit për sa i përket motit në Tiranë. Gjatë këtij muaji mund të prisni: pothuajse çdo ditë reshje shiu, zakonisht stuhi, herë pas here mjegull dhe mot të këndshëm dhe të ngrohtë. Gama e temperaturave mesatare të ditës do të jetë rreth 19°C dhe 26°C . Zakonisht java e tretë është më e nxehta në maj, por mund të ketë Shi dhe Bullllima.

Ngjarjet e motit që mund të ndodhin gjatë udhëtimit për në Tiranë:

13 herë Shi, 9 herë stuhi (bubullima), më pak se 1 herë Mjegull. Tirana në maj do të përjetojë ditë miqësore me një temperaturë të lartë me qiell me vranësira të forta. Zakonisht temperatura do të luhatet rreth 23°C dhe do të ndihet për 26° C dhe era do të jetë fllad i lehtë.

